





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS GODIŠNJI IZVEŠTAJ PERFORMANSE ANNUAL PERFORMANCE REPORT 2020



Prill, 2021



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2020

Prishtinë, Prill 2021



Anëtarësimi me të drejta të plota



INTOSAI

Shtator 2019



E U R O S A I

Nëntor 2020

INTOSAI

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit

INTOSAI është organizatë autonome, e pavarur dhe jopolitike dhe ka për qëllim të ofrojë mbështetje për të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit; të vendos standardet ndërkombëtare të auditimit për sektorin publik; si dhe të promovoj qeverisjen e mirë dhe të nxisë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes Institucioneve Supreme të Auditimit. Kjo organizatë ka 195 anëtarë.



Gusht/shtator 2019: Vendimi i Bordit Drejtues për pranimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, me të drejta të plota në INTOSAI



1 janar 2020: Hyrja në fuqi e anëtarësimi të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës në INTOSAI, me të drejta të plota

EUROSAI

Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit

EUROSAI është një nga organizatat regjionale të INTOSAI-t dhe përbëhet nga 51 anëtarë (Institucione Supreme të Auditimit të vendeve të Evropës dhe Gjykata Evropiane e Auditimit).



12 Nëntor 2020: Vendimi i Bordit Drejtues për pranimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, me të drejta të plota në EUROSAI



14 Prill 2021: Pjesëmarrja e Zyres Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës në Kongresin e XI të EUROSAI, hyrja në fuqi e të drejtës për të votuar si anëtar me të drejta të plota

TABELA E PËRMBAJTJES

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm	6
Vizioni, Misioni dhe Vlerat.....	10
Përmbledhje e fakteve kryesore për vitin 2020.....	11
1.Performanca e Zyrës Kombëtare të Auditimit	15
1.1.Pavarësia dhe Korniza ligjore	16
1.1.1.Pavarësia institucionale.....	16
1.1.2.Mandati.....	18
1.2.Qeverisja e brendshme dhe etika.....	18
1.2.1.Planifikimi strategjik dhe operativ.....	19
1.2.2.Mjedisi i kontrollit organizativ	20
1.2.3.Komunikimi i brendshëm	21
1.3.Cilësia e auditimit dhe raportimi	21
1.3.1.Fushë veprimi i ZKA-së - llojet e auditimit.....	22
1.3.2.Auditimet e planifikuara dhe të realizuara	23
1.3.3.Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve	25
1.3.4.Konrolli i cilësisë	34
1.4.Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse.....	35
1.4.1.Menaxhimi financiar	35
1.4.2.Shërbimet mbështetëse	39
1.4.3.Menaxhimi i pandemisë COVID-19.....	40
1.5. Menaxhimi i Burimeve njerëzore	40
1.5.1.Burimet njerëzore	40
1.5.2.Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit	42
1.6.Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit	45
1.6.1.Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin.....	46
1.6.2.Komunikimi me Mediat, Qytetarët, Organizatat e Shoqërisë Civile, Donatorët dhe akterë të tjerë	48
1.6.3.Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere, marrëveshjet bilaterale, takimet e vizitat.....	51
2. Fokusi i aktiviteteve gjatë vitit 2021	58
3. Llogaridhënia e ZKA-së.....	60
Shtojcat.....	61
Shtojca 1: Portofoli i auditimeve për sezonin 2019/20 dhe 2020/21	62
Shtojca 2: Pasqyrat Financiare Vjetore të ZKA-së për vitin 2020.....	65

FJALORI I SHPREHJEVE

AB	Auditori i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
BE	Bashkimi Evropian
BK	Buxheti i Kosovës
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA)
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KIDP	Korniza e INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale
KBT	Komisioni për Buxhet dhe Transfere
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
NP	Ndërmarrje Publike
OB	Organizata Buxhetore
PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore
RVP	Raporti Vjetor i Performancës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
RFV/BK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNAO	Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
TI	Teknologjia Informative
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit



Besnik Osmani,
Auditor i Përgjithshëm

FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin Vjetor të Performancës dhe Raportin e auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për vitin 2020. Puna jonë është mbështetur në Planin Strategjik 2018-2021, Planin Vjetor të Auditimit 2019/20, që paraprakisht i është dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe në Planin operativ 2020.

Pavarësisht se viti 2020 ka qenë sfidues për shkak të ndikimit të pandemisë COVID 19, kemi arritur t'i përmbushim të gjitha kërkesat dhe afatet ligjore për punën audituese, duke forcuar mbulueshmërinë dhe cilësinë e auditimit. Gjatë vitit 2020 kemi kryer numrin më të lartë të auditimeve të rregullsisë që nga themelimi. Kemi audituar 95 organizata buxhetore me një buxhet të përgjithshëm rreth 2.5 miliardë euro, 14 ndërmarrje publike kryesisht në fushën e telekomunikimit, furnizimit me ujë dhe trajtimit të mbeturinave, 8 auditime të performancës me fokus tema komplekse, si dhe 9 projekte të financuara nga fondet e donatorëve.

Paralelisht, kemi përditësuar doracakët dhe letrat e punës sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira ndërkombëtare dhe kemi digjitalizuar procesin e punës audituese ku kemi lancuar sistemin elektronik të auditimit SITA, përmes së cilit do të racionalizohet koha në auditim, rritet cilësia dhe siguria e auditimeve dhe forcohet transparenca.

Kemi kryer të gjitha përgatitjet metodologjike dhe kemi trajnuar personelin për të aplikuar për herë të parë aktivitetet e përputhshmërisë me kornizën rregullative që do të rezultoj me një opinion të pajtueshmërisë.

Sukseset në rrafshin ndërkombëtar kanë kulmuar me integrimin e ZKA-së si anëtare në dy organizata ndërkombëtare, Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)¹ dhe në Organizatën Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI). Poashtu, është nënshkruar edhe marrëveshja trevjeçare e bashkëpunimit bilateral me partnerin tonë strategjik, Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë.

Në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe partnerët ndërkombëtar kemi hartuar strategjinë e komunikimit, si mjet thelbësor për promovimin e praktikave të mira, të llogaridhënies dhe rritjen e transparencës.

Jam i lumtur që përmes rekomandimeve praktike, ZKA-ja ka shtrirë më tej ndikimin e saj, ku është vërejtur një progres i lehtë në rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

Dua të nënvizoj përkrahjen e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, në veçanti të anëtarëve të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike për trajtimin e raporteve të ZKA-së.

¹ Vendimi për antarësimin e ZKA-së në INTOSAI është marrë në shtator të vitit 2019, por ka hyrë në fuqi në Janar 2020.




**VIZIONI,
MISIONI
DHE VLERAT**

VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

Vizioni

Institucion i besueshëm i auditimit, që përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve.

Vlerat e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)




Misioni

Përmes auditimeve cilësore fuqizon llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.


PËRMBLEDHJE E FAKTEVE KRYESORE PËR VITIN 2020

- ✓ Gjatë vitit 2020 janë publikuar 119 auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë), që përbën numrin më të madh të këtyre auditimeve që nga themelimi i ZKA-së.
- Numri i auditimeve të rregullsisë është rritur në 28% përqind krahasuar me vitin 2015.
- Auditimi i Ndërmarrjeve Publike (NP) ka filluar në vitin 2016 me 4 NP, ndërsa në vitin 2020 është rritur në 14 NP.
- Numri i auditimeve për projektet e financuara nga donatorët, ka filluar në vitin 2016 me 2 projekte, ndërsa është rritur në 9 projekte në vitin 2020.


Grafiku 1. Portofoli i auditimeve



Grafiku 2. Auditimi i NP-ve



Grafiku 3. Auditimi i Projekteve të Donatorëve



Çështjet kryesore (nga Raporti Vjetor i Auditimit – RVA 2019)

Në Raportin Vjetor të Auditimit 2019 është kërkuar vëmendja e Kuvendit dhe krerëve të institucioneve publike, për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me:


- Planifikimin buxhetor
- Cilësinë e raportimit
- Keq klasifikimet e shpenzimeve
- Mosefikasiteti në shpenzimin e fondeve nga borxhet publike,
- Menaxhimin e llogarive të arkëtueshme
- Detyrimeve e papaguara dhe detyrimet kontigjente
- Regjistrimin, prezantimin dhe trajtimit i pasurive
- Pajtueshmërinë me kuadrin ligjor si: dobësitë në prokurim, menaxhimin e projekteve, menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve, rekrutimet, procedurat për subvencione, etj

Ndikimi i punës së ZKA-së


- Përmirësimi i raportimit financiar në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit
- Zvogëlimi i transaksioneve financiare të parregullta
- Përmirësimi i gabimeve si rezultat i auditimit (kthimi i pagesave në buxhet)
- Rritja e transparencës për shpenzimin e parasë publike
- Përmirësimi i mbikëqyrjes profesionale të zbatimit të projekteve

- ✓ Për vitin fiskal 2019 janë dhënë 920 rekomandime të auditimit
- ✓ Institucionet e pavarura prijnë për nga numri i rekomandimeve të zbatuara, megjithatë progresi i përgjithshëm nuk është ende i kënaqshëm.

Grafiku 4. Rekomandimet e auditimit të rregullsisë për vitin 2019



Grafiku 5. Progresi në zbatimin e rekomandimeve



Përmbledhje e pasqyrave financiare të ZKA-së, për vitin fiskal 2020

Shpenzimet për Paga e Meditje dhe Mallra e Shërbime mbesin shpenzimet kryesore të ZKA-së. Ndikim në rritjen e përgjithshme të buxhetit për vitin 2020, krahasuar me vitin paraprak, ka pasur ndarja buxhetore në kuadër të shpenzimeve kapitale për zhvillimin e "Softuerit për Menaxhimin e Auditimit"

Grafiku 6. Shpenzimet e ZKA-së për vitin fiskal 2020




Tabela 1. Përmbledhje e pasqyrave financiare të ZKA-së (€ 000)

Tabela e Pasqyrave Financiare të ZKA-së			
Burimet e Fondeve	2020	2019	2018
Granti Qeveritar	3,041	2,895	2,678
Grantet e Percaktuar të Donatorëve		95	18.8
Totali i Pranimeve	3,041	2,990	2,697
Shfytëzimi i fondeve			
Operacionet			
Pagat dhe Meditjet	2,216	2,125	2,003
Mallrat dhe Shërbime	523	710	613
Shërbimet Komunale	30	33	30
	2,769	2,868	2,646
Kapitalet			
Shpenzimet Kapitale	272	122	51
Totali i pagesave	3,041	2,990	2,697

1 PERFORMANCA E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT

1. PERFORMANCA E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Raporti i performancës së aktiviteteve të Zyres Kombëtare të Auditimit (ZKA), për vitin 2020 bazohet në strukturën e **Kornizës për Matjen e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit**. Kjo kornizë u ofron ISA-ve mundësinë që të vlerësojnë nivelin e performancës së tyre kundrejt **Kornizës së INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale** (KIDP) dhe praktikave të mira të njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik. Përmes kësaj Kornize, vlerësohet kontributi i ISA-ve, drejt forcimit të përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit dhe u jep ISA-ve, mundësi të bëhen organizata model, duke udhëhequr nga shembulli i mirë në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies përmes raportimit të besueshëm publik mbi performancën e tyre.

Korniza e Matjes së Performancës së ISA-ve, si dokument standard i INTOSA-it, përmban gjashtë fusha kryesore: 1. Pavarësia dhe Korniza ligjore; 2. Qeverisja e Brendshme dhe Etika; 3. Cilësia e Auditimit dhe Raportimi; 4. Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet mbështetëse; 5. Burimet njerëzore dhe Trajnimet si dhe 6. Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit. Këto fusha pastaj janë të ndara në 26 tregues, të cilët mundësojnë matjen e performancës së ISA-ve kundrejt praktikave më të mira ndërkombëtare.

Së këndejmi, Raporti i performancës, përfshinë shënime të rëndësishme në lidhje me performancën e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm në përmbushjen e obligimeve të tij kushtetuese e ligjore, në pajtim me SNISA-t.

1.1. Pavarësia dhe Korniza ligjore

Kjo fushë mbulon **mandatin ligjor** dhe **pavarësinë** e institucionit të **Auditorit të Përgjithshëm** (AP)². Përveç Kornizës ligjore të vendit, Kushtetutës dhe ligjeve relevante, bazë e praktikave të mira ndërkombëtare për këtë fushë janë: Deklarata e Limës (INTOSAI-P 1) dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve (INTOSAI-P 10). Treguesit që ZKA-ja ka aplikuar për këtë fushë janë: *pavarësia dhe mandati*.

1.1.1. Pavarësia institucionale

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka cilësuar Auditorin e Përgjithshëm si institucion të pavarur dhe më të lartë, të kontrollit ekonomik e financiar në vend. Kompetencat themelore të AP-së janë përcaktuar me **Kushtetutë** dhe janë definuar më tej me ligjin e veçantë nr. **05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit** (Ligji i ZKA-së). Sipas legjisllacionit në fuqi, AP-ja ka

² Në këtë Raport, institucionit të Auditorit të Përgjithshëm do t'i referohemi edhe si Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij. Ai është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së.

Gjatë vitit 2020, nuk janë shënuar raste të ndonjë ndërhyrjeje nga palët e treta në punën e AP-së.³

Një nga parimet bazë të funksionimit të Auditorit i Përgjithshëm është kushtetutshmëria dhe ligjshmëria. Për zbatimin e këtyre parimeve, është materializuar pavarësia kushtetuese e Auditorit të Përgjithshëm përmes kornizës së brendshme normative, e cila ka marrë dimensione të reja në vitin 2020. Në fakt, Auditori i Përgjithshëm i ka dhënë theks të ri kësaj kornize duke aprovuar strukturën e re organizative dhe duke rregulluar specifikat lidhur me marrëdhënien e punës për të gjithë nëpunësit e ZKA-së. Kjo është bërë pas nxjerrjes së Aktgjykimit (KO203/19) të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë. Duke përcaktuar qartë vijën e demarkacionit mes pushteteve (veçanërisht atij ekzekutiv) kundrejt pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese përfshirë Auditorin e Përgjithshëm, ky aktgjykim ka rikonfirmuar rrënjosjen e drejtpërdrejtë të pavarësisë funksionale dhe organizative të Auditorit të Përgjithshëm në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe përfundimisht ka shmangur diskutimet dhe kontestimet e mëtejme eventuale⁴.

Në anën tjetër, edhe Ligji aktual për ZKA-në ka nevojë për amendamentim për sa i përket të drejtës së Qeverisë për të modifikuar kërkesën buxhetore të ZKA-së⁵. Në lidhje me këtë, AP-ja i ka informuar edhe deputetët e Kuvendit, anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike si dhe ata të Komisionit për Buxhet dhe Transfere, mirëpo për shkak të shpërbërjes së Kuvendit, nuk ka mundur të iniciohet procesi i ndryshimit të ligjit. Një ndryshim tjetër i rëndësishëm i këtij ligji ka të bëjë me heqjen e obligimit për auditime të përvitshme të rregullsisë, për të gjitha organizatat buxhetore (pavarësisht madhësisë, kompleksitetit, rrezikut, etj), i cili krijon një barrë të panevojshme për ZKA-në dhe pamundëson aplikimin e qasjes së përzgjedhjes së auditimeve bazuar në rrezik.

3 Një rrethanë e fillë me ndikim në cenimin e pavarësisë së Auditorit të Përgjithshëm ishte nënvizuar në raportin tonë të performancës për vitin paraprak 2019 me rrezikun e ndërhyrjes në pavarësisë e AP-së përmes Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë.

4 Kjo pavarësi, përveç tjerash, ndërlidhet edhe në çështjet rreth strukturës organizative, të funksionimit, klasifikimit të pozitive, kushteve të veçanta për rekrutim, etj., për personelin e ZKA-së.

5 Në bazë të praktikave të mira ndërkombëtare (Deklarata e Limës dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve) për të siguruar pavarësinë e plotë financiare, rekomandohet që buxheti i ISA-ve të trajtohet drejtpërdrejt nga Kuvendi.

1.1.2.Mandati

Ky tregues vlerëson autoritetin operacional të ZKA-së, të përcaktuar në Kornizën ligjore. Dimensionet për të vlerësuar këtë tregues janë: mandati i mjaftueshëm dhe i gjerë; qasja në informata; dhe e drejta dhe detyrimi për të raportuar.

Kushtetuta e vendit dhe Ligji i veçantë, i japin AP-së **mandat të gjerë të auditimit** të të gjitha subjekteve të sektorit publik në Kosovë. Megjithatë, disa ligje të veçanta kanë krijuar paqartësi për auditimin e disa institucioneve publike që çështjen e auditimit e kanë trajtuar në mënyrë tjetër krahasuar me dispozitat kushtetuese dhe ato të Ligjit për AP-në⁶. Për më tepër, Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk është harmonizuar me Kushtetutën, Ligjin për AP-në dhe Ligjin për Ndërmarrjet publike (NP), lidhur me mandatin e AP-së për auditimin e NP-ve dhe afatet kohore për raportim financiar.

AP-ja, sipas autoritetit kushtetues e ligjor, ka **qasje të pakufizuar** në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit. Gjatë periudhës raportuese, bashkëpunimi me subjektet e audituara ka qenë korrekt dhe nuk është shënuar ndonjë rast i kufizimit të qasjes për auditorët. Zyrtarëve të autorizuar nga AP-ja u është mundësuar që në çdo kohë të arsyeshme të hyjnë dhe të qëndrojnë në objektet e entiteteve të audituara.

AP-ja e ka autoritetin kushtetues që në mënyrë të pavarur të **raportojë gjetjet** e çdo viti në Kuvend. AP-ja më 2 nëntor 2020 ka prezantuar para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin Vjetor të Auditimit për vitin fiskal 2019. Me këtë rast, AP-ja ka ftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës që të kërkojë rritjen e përgjegjësisë llogaridhënëse nga institucionet e audituara në mënyrë që të ndërmarrin veprime të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve dhe adresimin e mangësive të raportuara.⁷

Sikurse edhe gjatë viteve paraprake, **ZKA-ja i ka bërë publike të gjitha raportet e auditimit.**

1.2. Qeverisja e brendshme dhe etika

Kjo fushë mbulon **qeverisjen e brendshme** dhe **etikën**. Treguesit që ZKA-ja ka aplikuar janë: Planifikimi strategjik dhe operativ; mjedisi i kontrollit organizativ; dhe komunikimi i brendshëm.

6 BQK – Banka Qendrore e Kosovës; AKI – Agjencia Kosovare e Inteligjencës, RTK – Radio Televizioni i Kosovës, FPKK – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Ndërmarrja Trepça.

7 Puna dhe rezultatet e Zyrës Kombëtare të Auditimit janë adresuar edhe në Raportin e Progresit për Kosovën (për vitin 2020). Komisioni Evropian i ka kërkuar Kuvendit, që t'i ndjekë më sistematikisht rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit, kurse vetë ZKA-së i ka kërkuar që të bëjë përpjekje të vazhdueshme në fushën e komunikimit, për të forcuar imazhin e saj të përgjithshëm.

1.2.1. Planifikimi strategjik dhe operativ

ZKA-ja zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në Planin Strategjik trevjeçar, Planin Operativ Vjetor dhe Planin Vjetor të Auditimit.

Planifikimi Strategjik

Gjatë vitit 2020, ZKA-ja ka intensifikuar angazhimin për realizimin e Planit Strategjik 2018-2021, përkatësisht arritjen e qëllimeve kryesore strategjike, që janë:

1. Përbushja e misionit kushtetues e ligjor, duke kryer auditime relevante në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit;
2. Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur auditimin dhe qeverisjen korporative; si dhe
3. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e marrëdhënieve të mira me palët e jashtme, duke promovuar auditimin, rritur ndikimin dhe duke u integruar në organizatat globale dhe rajonale të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Sipas vetëvlerësimit nga ZKA-ja, përkundër sfidave të natyrave të ndryshme, është bërë një progres i konsiderueshëm në përbushjen e objektivave strategjike të planifikuara me Planin Strategjik, si në rrafshin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Pas vlerësimit të strategjisë do të fillojnë përgatitjet për hartimin e planit të ri strategjik.

Plani Operativ Vjetor

Në kohën kur bota është përballur me pasojat serioze të pandemisë Covid-19, Institucionet Supreme të Auditimit kishin reduktuar planet e tyre të auditimit, duke aplikuar qasjen e auditimit të bazuar në rrezik. ZKA-ja nuk e gëzonte këtë mundësi për shkak të kuadrit ligjor ekzistues, i cili obligon Auditorin e Përgjithshëm që të auditojë të gjitha organizatat buxhetore për çdo vit, pavarësisht shkallës së rrezikut dhe rrethanave specifike, siç është ajo e pandemisë Covid 19.

Përkundër vendimeve të Qeverisë për të punuar me staf esencial, në mungesë të një akti të veçantë nga Kuvendi i Kosovës që do t'i mundësonte ZKA-së zbatimin e qasjes së auditimit bazuar në rrezik, ZKA-ja ka vazhduar me përbushjen e të gjitha kërkesave dhe afateve ligjore.

Për më tepër, ZKA-ja, me qëlim të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës së shpenzimeve publike në lidhje me COVID-19, ka planifikuar që në kuadër të auditimeve të sezonit 2020/21 të vlerësoj mënyrën e shpenzimit të fondeve të dedikuara për luftimin e pandemisë.

Plani Vjetor i Auditimit

Në fillim të sezonit auditues, AP-ja ka miratuar Planin Vjetor të Auditimit 2020/21, i cili përfshinë periudhën 1 shtator 2020 deri më 31 gusht 2021 dhe përmban informatat themelore për objektivat vjetore të ZKA-së, procesin e auditimit dhe llojet e tij, Planin Vjetor të Auditimit dhe organizimin, buxhetin dhe burimet

njerëzore. Në hartimin e Planit janë marrë në konsideratë përmbushja e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë, mbulueshmëria sa më e gjerë me auditime të performancës bazuar në vlerësimin mbi rëndësinë dhe aktualitetin e çështjeve të caktuara dhe adresimi i kërkesave specifike të palëve të interesit, si: organizatat e shoqërisë civile, donatorët, etj. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh edhe kapacitetet e burimeve njerëzore dhe financiare që ZKA-ja ka pasur në dispozicion. Ky Plan i është dorëzuar për informim KMFP-së në fillim të sezonit auditues.

1.2.2.Mjedisi i kontrollit organizativ

Në respektim të kërkesave që burojnë nga SNISA-t8, si dhe për të përmbushur pritjet nga ZKA-ja, AP-ja ka miratuar strukturën e re organizative, me qëllim të arritjes së objektivave strategjike të organizatës. Struktura e re është po ashtu, në funksion të krijimit të një sistemi të kontrollit të brendshëm që ofron siguri të arsyeshme se operacionet e organizatës menaxhohen në mënyrë efikase dhe ekonomike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Kodi i Etikës

Në funksion të afirmimit të vlerave dhe parimeve thelbësore që udhëheqin punën e përditshme të auditorëve, si dhe për të ruajtur dhe shtuar besimin te institucioni, ZKA-ja ka krijuar politika dhe procedura, të cilat kërkojnë që gjithë personeli dhe palët e autorizuarra për të kryer punë për ZKA-në, të pajtohen me kërkesat etike, duke nënshkruar dhe respektuar **Kodin e Etikës** dhe **Deklaratën e pavarësisë profesionale**. Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes i ZKA-së është hartuar në frymën e parimeve që përmban Kodi i Etikës i INTOSAI-t. Po ashtu, në ZKA funksionon edhe **Komisioni për Etikë** me mandat që të përcjellë zbatueshmërinë e Kodit të Etikës.

Sistemi i kontrollit të brendshëm

Kontrollet e brendshme për aktivitetet joaudituese në ZKA zbatohen përmes rregullave dhe procedurave të vendosura për procese të ndryshme, si: ndarja e detyrave, delegimi, autorizimi, mbikëqyrja dhe auditimi i brendshëm. Po ashtu, ZKA-ja ka hartuar edhe dokumentin për menaxhimin e rreziqeve. Menaxhimi i rrezikut në ZKA zbatohet, duke u bazuar në objektivat e vendosura me dokumentet strategjike të ZKA-së dhe kornizën tjetër të aplikueshme për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK). Lidhur me këtë, ZKA-ja ka të dizajnuar një strukturë të mirë të kontrolleve të brendshme. Të gjitha komponentët e kontrolleve operojnë në mënyrë efektive, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve.

Auditori i brendshëm (AB) i ZKA-së gjatë vitit 2020, i ka dorëzuar AP-së kater (4) raporte të auditimit, në temat lidhur me procesin e rekrutimit, menaxhimin e procesit të komunikimit në ZKA, procesin e buxhetimit dhe financat, si dhe menaxhimin e cilësisë në ZKA.

8 Standardi i Qeverisjes 9100, Kontrolli dhe siguri i cilësisë SNISA 140.

Komiteti i Auditimit (KA) ka kryer aktivitetet e tij me qëllim të ngritjes së llogaridhënies dhe përmirësimit të qeverisjes në ZKA. KA-ja i ka shqyrtuar të gjitha raportet e AB-së.

1.2.3. Komunikimi i brendshëm

ZKA-ja ka ndërtuar një komunikim efektiv të brendshëm me punonjësit, duke i dhënë mundësi secilit punonjës të shprehet hapur, si në drejtimin vertikal ashtu edhe në atë horizontal për çështjet që lidhen me punën e tyre si dhe për ato në nivel të institucionit. Menaxhmenti i ZKA-së përmes platformave elektronike ka mbajtur takime periodike⁹ me personelin, sipas nevojave zhvillimore dhe të menaxhimit të pandemisë. Vendimet kryesore janë dokumentuar dhe i janë komunikuar stafit me kohë.

Dokumentet relevante janë të qasshme për të gjitha nivelet organizative dhe informacioni shpërndahet tek i tërë stafi, qoftë përmes komunikimit elektronik (e-mail apo rrjeti i brendshëm), apo përmes takimeve, ku punonjësit janë informuar rregullisht mbi çështjet kryesore lidhur me organizatën dhe procesin e auditimit. Puna audituese dokumentohet dhe raportohet përmes organizimit dhe mbajtjes së folderëve publik¹⁰ dhe kjo ka rritur transparencën dhe kontrollin e cilësisë së punës sonë.

1.3. Cilësia e auditimit dhe raportimi

ZKA-ja auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të subjekteve publike për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është aprovuar. ZKA-ja, po ashtu kryen auditime të performancës për të vlerësuar nëse qytetarëve u ofrohen shërbimet që kanë nevojë, me kosto efektive.

Treguesit e kësaj fushe ndërlidhen kryesisht me: fushëveprimin/cilësinë e auditimeve; raportimin e rezultateve të auditimeve dhe adresimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara.

⁹ Takimet janë mbajtur online apo me prezencë fizike, varësisht nga rrethanat.

¹⁰ Sezoni auditës 2020/2021 kryhet përmes Sistemit Informativ të Auditimit- SITA.

1.3.1.Fushë veprimi i ZKA-së - llojet e auditimit

Në përputhje me mandatin e saj ligjor, ZKA-ja kryen kryesisht këto lloje të auditimeve¹¹:

1. Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)	<ul style="list-style-type: none">• Të organizatave buxhetore (ministrive, institucioneve të pavarura dhe komunave), bazuar në sistemin e parasë së gatshme
	<ul style="list-style-type: none">• Të ndërmarrjeve publike, bazuar në sistemin aktual
	<ul style="list-style-type: none">• Të projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare
2. Auditime të performancës	<ul style="list-style-type: none">• Të angazhimeve qeveritare, sistemeve, operacioneve, programeve, aktiviteteve ose organizatave
	<ul style="list-style-type: none">• Të projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare
3. Auditime të teknologjisë së informacionit (TI)	<ul style="list-style-type: none">• Të sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI) dhe kontrolleve të ndërlidhura me to

Auditimet e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) në subjektet individuale kryhen për çdo vit, duke filluar në shtator, ndërsa përfundojnë me raportet e auditimit, të cilat publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve të rregullsisë përmbyllet në fund të muajit gusht, kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës. Fushat, objektivat, koha e auditimit dhe e raportimit të **auditimeve të performancës** përcaktohen në Planin Vjetor të Auditimit, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, kapacitetet ekzistuese, si dhe kriteret e tjera përkatëse.

Në bazë të marrëveshjes me donatorët apo përfituesit e tyre, ZKA-ja kryen auditime të rregullsisë (financiare dhe pajtueshmërisë) apo të performancës së projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Auditimi i projekteve që financohen nga Banka Botërore, qeveritë e vendeve të ndryshme, etj është edhe një tregues për besueshmërinë dhe cilësinë e punës audituese të ZKA-së.¹²

11 Auditimet e TI-së, ZKA-ja i ka zhvilluar kryesisht në kuadër të auditimeve të performancës. Përgjithësisht ISA-të kryejnë auditimin e TI-së njëkohësisht me auditimin e pasqyrave financiare, rishikimin e kontrolleve të brendshme ose si auditim performance të sistemeve të TI-së ose të aplikimeve të TI-së. Auditimet e TI-së shtrihen në auditimet financiare (për të vlerësuar saktësinë e pasqyrave financiare të subjektit); në auditimet e pajtueshmërisë (vlerësimi i kontrolleve të brendshme); në auditimet e performancës (përfshirë çështjet e sistemeve të informacionit), etj.

12 Auditimet e TI-së, ZKA-ja i ka zhvilluar kryesisht në kuadër të auditimeve të performancës. Përgjithësisht ISA-të kryejnë auditimin e TI-së njëkohësisht me auditimin e pasqyrave financiare, rishikimin e kontrolleve të brendshme ose si auditim performance të sistemeve të TI-së ose të aplikimeve të TI-së. Auditimet e TI-së shtrihen në auditimet financiare (për të vlerësuar saktësinë e pasqyrave financiare të subjektit); në auditimet e pajtueshmërisë (vlerësimi i kontrolleve të brendshme); në auditimet e performancës (përfshirë çështjet e sistemeve të informacionit), etj.

1.3.2. Auditimet e planifikuara dhe të realizuara

Deri në fund të vitit 2020, ZKA-ja ka përfunduar dhe publikuar 127 raporte, si në vijim:

119 Raporte të auditimit të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)

- ✓ Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2019
- ✓ 95 raporte për organizatat buxhetore
- ✓ 14 raporte të auditimit për Ndërmarrjet Publike, dhe
- ✓ 9 raporte të auditimit të projekteve (të financuara nga donatorët).

8 raporte të auditimit të performancës

- ✓ 8 raporte të auditimit të performancës (për fusha të ndryshme si: ekonomia, shëndetësia, arsimi, investimet publike, prokurimi publik, mjedisi dhe teknologjia informative).

Ndërsa, me Planin Vjetor për sezonin e auditimit 2020/21, ZKA-ja planifikon¹³ të kryejë auditimet, si në vijim:

116 Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)

- ✓ Auditimin e Raportit Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2020
- ✓ 90 organizata buxhetore (52 institucione të nivelit qendror dhe 38 të nivelit lokal)¹⁴
- ✓ 12 Ndërmarrje Publike, dhe
- ✓ 13 auditime të projekteve (të financuara nga donatorët).

8 Auditime të performancës

- ✓ 8 auditime të performancës (për fusha të ndryshme).

Për sezonin auditues 2020/21, në portofolin e auditimeve të rregullsisë kemi një zvogëlim të ministrive për arsye të ristrukturimit të Qeverisë dhe një rritje të auditimit të projekteve të financuara nga donatorët e jashtëm. Ndërsa, për dallim nga sezoni i kaluar këtë sezoni kemi dy NP më pak.

Tabela 2 tregon portofolin e përgjithshëm të auditimeve, përfshirë numrin dhe llojet e auditimeve të paraqitura me një bazë krahasuese për pesë(5) sezonet/vitet e fundit të auditimit. Evidenca e raporteve të përfunduara dhe të auditimeve në proces është paraqitur në Shtojcën 1 të këtij Raporti.

¹³ Për shkak të ndikimit të pandemisë COVID 19 në funksionimin normal të institucioneve publike në Kosovë, ZKA-ja do të sfidohet në realizimin e plotë dhe me kohë të planit të auditimit.


¹⁴ ZKA-ja ka angazhuar një kompani private të auditimit, e cila do të përkrahë procesin auditimin të 22 Institucioneve të Pavarura dhe tri komunave. Megjithatë sigurimi i cilësisë së raporteve dhe dhënia e opinionit të auditimit do të bëhet nga AP-ja.

Tabela 2. Portofoli i përgjithshëm i auditimeve gjatë pesë sezoneve/viteve të fundit


Llojet e auditimit	Vitet				
	2020	2019	2018	2017	2016
Auditime të rregullsisë	119	115	109	99	93
• Buxheti i Kosovës	1	1	1	1	1
• Institucione qendrore	57	56	54	54	54
• Komuna	38	38	38	38	38
• Ndërmarrje publike	14	11	9	4	0
• Projekte	9	9	7	2	0
Auditime të performancës	8¹⁵	13	13	11	5
• Performancë dhe prokurim	5	11	10	9	5
• Teknologji Informative	3	0	3	2	-
• Projekte	-	2	-	-	-
Gjithsej	127	128	122	110	98

Siç është prezantuar në Tabelën 2 dhe Grafikun 6 nga viti 2016 në 2020, kemi një rritje të numrit të auditimeve të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) nga 93 në 119 auditime apo 28% më shumë auditime. Kjo rritje i atribuohet kryesisht zgjerimit të portofolit të auditimeve të Ndërmarrjeve Publike si dhe auditimit të projekteve të financuara nga donatorët. Përderisa në vitin 2016, nuk kishte në portofolion e auditimeve asnjë ndërmarrje publike, gjatë vitit 2020, ZKA-ja ka audituar 14 ndërmarrje publike.

Grafiku 7. Trendi i auditimeve të rregullsisë



Grafiku 8. Trendi i auditimeve të performancës



15 Në planin e vitit 2020 ishin të planifikuara më shumë auditime të performancës, mirëpo për shkak të situatës së krijuar të pandemisë dhe angazhimit personelit në kryerjen e auditimit të projekteve pritet që këto auditime të finalizohen në vitin 2021.

1.3.3. Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve

Auditimet e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)

Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Pasqyrat Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës të vitit 2019 është dorëzuar në Kuvendin e Kosovës brenda afatit ligjor. Auditori i Përgjithshëm ka prezantuar RVA-në në seancë plenare.

Çështjet kryesore të RVA-së nënvizojnë nevojën për një vëmendje më të shtuar të drejtuesve të lartë dhe mbajtësve të buxhetit për forcimin e masave dhe përmirësimin e proceseve në fushat si në vijim:

- planifikimin buxhetor,
- cilësinë e raportimit,
- keq klasifikimet e shpenzimeve
- mos efikasitetin në shpenzimin e fondeve nga borxhet publike,
- menaxhimin e llogarive të arkëtueshme,
- detyrimet e papaguara dhe detyrimet kontigjente si dhe
- regjistrimin, prezantimin dhe trajtimin jo adekuat të pasurive.

Në RVA janë pasqyruar edhe çështje që ndërlidhen me **pajtueshmërinë me kuadrin ligjor**, si:

- dobësitë në prokurim, menaxhimin e projekteve,
- në menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve,
- rekrutimet, procedurave për subvencione etj,

Për të gjitha këto çështje janë dhënë rekomandime konkrete.

Ndonëse nuk janë bërë vlerësime individuale për të kuptuar më saktë ndikimin e rekomandimeve të auditimit për subjektet e audituara, konkludimi i përgjithshëm është se **ndikimi i punës së ZKA-së** mund të vërehet në fushat si në vijim: përmirësimi i raportimit financiar; zvogëlimi i transaksioneve financiare të parregullta; **përmirësimi i gabimeve si rezultat i auditimit; rritja e transparencës për shpenzimin e parasë publike** (të gjitha raportet e auditimit janë publikuar dhe raportet e performancës janë prezantuar para publikut dhe palëve të interesit), etj.

Në raportet individuale të auditimit të organizatave buxhetore dhe NP-ve, të realizuara gjatë vitit 2020, të cilat kishin në fokus pasqyrat financiare të vitit 2019, është raportuar edhe progresi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna një vit më parë. Ky progres është paraqitur në tabelën e mëposhtme (tabela 3), derisa zbatimi i rekomandimeve për vitet 2018 dhe 2017 është përmbledhur në tabelat 4, dhe 5.

Tabela 3. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2019 (për v. 2018), nga OB

Subjektet e audituara	Rekomandime të dhëna	Të zbatuara		Të zbatuara pjesërisht apo në proces		Të pa zbatuara		Të mbyllura ¹⁶	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet qendror	274	111	41	32	12	101	37	30	11
Institucionet e pavarura	60	43	71	3	5	10	17	4	7
Komunat	586	217	37	76	13	201	34	92	16
Totali	920	371	40	111	12	312	34	126	14

Tabela 4. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2018 (për v. 2017), nga OB

Subjektet e audituara	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara		Të zbatuara pjesërisht apo në proces		Të pa zbatuara		Të mbyllura	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet qendrore	357	144	40	59	17	103	29	51	14
Institucionet e pavarura	164	106	65	19	12	22	13	17	10
Komunat	600	188	31	123	21	229	38	60	10
Totali	1,121	438	39	201	18	354	32	128	11

Tabela 5. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2017 (për v. 2016), nga OB

Subjektet e audituara	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara		Të zbatuara pjesërisht apo në proces		Të pa zbatuara	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet qendrore	307	112	36	57	19	138	45
Institucionet e pavarura	220	118	54	63	29	39	17
Komunat	650	165	25	191	29	294	45
Totali	1,177	395	34	311	26	471	40

Në auditimet e PFV-ve të organizatave buxhetore të vitit 2019, ZKA-ja ka dhënë gjithsej 920 rekomandime. Nga auditimet e realizuara është evidentuar një përmirësim i lehtë i nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga të gjitha institucionet. Në përgjithësi shkalla e zbatueshmërisë së rekomandimeve të auditimit është

¹⁶ Rekomandime të mbyllura janë konsideruar rekomandimet të cilat nuk mund të zbatohen qoftë për shkak se ato kanë të bëjnë më ngjarje të kaluara apo për shkak se rekomandimi nuk është në përputhje me rrethanat e reja të krijuara.

përmirësuar nga viti paraprake (nga 39% në 40%). Edhe pse ritja e zbatueshmërisë së rekomandimeve është e lehtë, për dallim nga vitet paraprake, tani ka një monitorim më të strukturuar të zbatimit të rekomandimeve, duke qenë se organizatat buxhetore raportojnë dy herë në vit në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimeve.

Sa i përket Ndërmarrjeve Publike, ZKA-ja ka audituar (11) NP për vitin fiskal 2018, rezultatet nga përcjellja dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve për këto NP janë paraqitur në Tabelën 6, më poshtë.

Tabela 6. Progresi në zbatimin e rekomandimeve nga NP-të e audituara në vitin fiskal 2018

Ndërmarrja publike e audituar	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara		Të adresuara pjesërisht apo në proces		Të pa zbatuara	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Hekurudhat e Kosovës -Trainkos	17	7	41	3	18	7	41
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK)	13	8	62	0	0	5	38
KRU Prishtina	39	10	26	4	10	25	64
KRM Uniteti	31	6	19	3	10	22	71
KRU Hidroregjioni Jugor	12	4	33	0	0	8	67
Stacioni i Autobusëve	19	9	47	3	16	7	37
Hortikultura	14	9	64	0	0	5	36
KRU Drini i Bardhë	21	12	57	5	24	4	19
Posta e Kosovës	17	10	59	7	41	0	0
Telekomi i Kosovës	32	13	41	3	9	16	50
KRM Pastrimi	37	16	43	2	5	19	51
Totali	252	104	41	30	12	118	47

Gjithashtu, ZKA-ja ka vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të RVA-së të dhëna për Kuvendin e Kosovës, Qeverinë dhe për kuvendet komunale. Nga gjithsej 51 rekomandime¹⁷ të dhëna, 14 janë zbatuar plotësisht, 18 ishin në proces të zbatimit dhe 19 të tjera nuk ishin zbatuar ende. Për 7 rekomandimet e dhëna

¹⁷ Prej këtyre rekomandimeve, 3 janë dhënë për Kuvendin e Kosovës, 47 për Qeverinë dhe 1 për Kuvendet komunale. Nga këto rekomandime, 7 janë dhënë në lidhje me auditimin e performancës.

për Qeverinë në auditimet e performancës, mbetet të bëhet auditimi përcjellës i zbatimit të tyre, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i saktë i progresit.

Për rekomandimet e dhëna në RVA për vitin 2019, Qeveria përkatësisht, Ministria e Financave ka përgatitur planin e veprimit në shtator të vitit 2020, ndërsa ZKA-ja do të vlerësoj progresin e tyre në RVA për vitin 2020, i cili do të finalizohet në gusht të vitit 2021.

Auditimet e performancës

Raportet e auditimit të performancës, të publikuara gjatë vitit 2020 kanë mbuluar fusha të rëndësishme me interes për qytetarët, Kuvendin dhe palët e tjera të interesit. Zhvillimi ekonomik, mirëqenia sociale, arsimi, shëndetësia, teknologjia e informacionit kanë qenë në fokus të auditimit për vitin 2020. Përmes këtyre auditimeve, ZKA-ja ka synuar të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike. Po ashtu, gjatë vitit 2020, rëndësi e veçantë i është dhënë kryerjes së auditimeve përcjellëse të performancës, më qëllim që t'i ofroj Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës një informacion lidhur me veprimet e ndërmarra nga institucionet publike për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Tabela 7. Temat e auditimeve të performancës sipas fushave

Nr. Audit	Fusha	Tema
1	ZHVILLIMI EKONOMIK DHE MIREQENIA SOCIALE	Procesi i licencimit të shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore e industriale dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari
1	ARSIMI	Efektiviteti i ndërlidhjes së arsimit dhe aftësisimit profesional me nevojat e tregut të punës
3	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	Organizimi dhe menaxhimi i investimeve të teknologjisë së informacionit në institucionet publike Menaxhimi i Obligimeve Tatimore në Sistemet e Informacionit të Administratës Tatimore të Kosovës Qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve në ASK
3	AUDITIMET PËRCJELLËSE	Zbatimi i rekomandimeve të raportit "Administrimi i programit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike dhe vlerësimi i rezultateve Zbatimi i rekomandimeve të raportit "Fondi Zhvillimor" dhe efektet e fondit" Raporti i vlerësimit të zbatimit të rekomandimeve për auditimet e performancës të vitit 2017"

Gjatë vitit 2020 janë publikuar 8 raporte të auditimit të performancës. Në këto raporte janë dhënë gjithsej 109 rekomandime për të adresuar gjetjet e konstatuara dhe për të përmirësuar proceset dhe mangësitë me të cilat janë duke u ballafaquar në sistemet aktuale.

Në vijim janë paraqitur shkurtimisht fokusi dhe përfundimet kryesore të këtyre raporteve.

Zbatimi i rekomandimeve të raportit “Fondi Zhvillimor” dhe efektet e fondit”

Ky auditim përcjellës kishte për **qëllim** t'i ofrojë Ministrit të Financave të Republikës së Kosovës dhe Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian një vlerësim lidhur me menaxhimin e projekteve kapitale të financuara nga fondit i ndarë enkas për katër komuna veriore dhe nëse është arritur qëllimi i synuar pra promovimi dhe zhvillimit social ekonomik.

Konkluzioni i auditimit përcjellës është se vetëm katër nga 13 rekomandimet e dhëna ishin zbatuar plotësisht, pesë pjesërisht ndërsa katër rekomandime nuk ishin zbatuar fare. Progresi është i limituar dhe mbetet hapësirë për menaxhim më të mirë dhe kontroll financiar gjatë zbatimit të projekteve të financuara nga ky fond.

Bordi Menaxhues i Fondit Zhvillimor nuk kishte mundur të zbatojë të gjitha rekomandimet lidhur me monitorimin e projekteve, shqyrtimin e kërkesave në nivel profesional teknik si dhe kërkesën për raportim të komunave mbi progresin e projekteve. Kjo është pamundësuar, në mes tjerash, si rezultat i dorëheqjeve të Kryetarëve të Komunave e që është pasuar me procesin e zgjedhjeve lokale dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Ministria e Financave projektet e financuara nga Fondi i kishte përfshirë në tabelat e buxhetit, kishte instaluar Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës tek katër komunat si dhe kishte ofruar trajnime relevante. Gjithashtu, kishte zbatuar pjesërisht rekomandimin sa i përket kategorizimit të shpenzimeve në kode të duhura. Komunat nuk e kishin zbatuar rekomandimin e dëgjimeve publike. Asnjëra komunë nuk e kishte kryer një analizë të rrethanave që kishin shkaktuar prolongimin e zbatimit ose moszbatimin e projekteve, rrjedhimisht asnjë masë lidhur me rritjen e efikasitetit nuk ishte ndërmarrë.

Për më shumë, komunat nuk ishin mjaft efikase në vënien në dispozicion të projekteve të financuara nga Fondi e në disa raste nuk ishin as efektive. Nga disa projekte qytetarët nuk kishin asnjë dobi edhe pse ishin përfunduar pasi që ende nuk ishin në dispozicion të tyre.

“Procesi i licencimit të shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore e industriale dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari”

Fokusi i këtij auditimi ishte vlerësimi i procesit të dhënies së licencave dhe lejeve për aktivitete minerare dhe aktivitetet e institucioneve publike për mbrojtjen e

mjedisit nga veprimtaria e nxjerrjes së mineraleve ndërtimore dhe industriale. Me qëllim që të japim rekomandime për përmirësimin dhe ruajtjen e mjedisit nga ndotja dhe degradimi gjatë shfrytëzimit të mineraleve dhe për përmirësimin e efikasitetit të sistemit të licencimit.

Rezultatet e auditimit kanë nxjerr në pah se proceset ekzistuese lidhur me licencimin e shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore e industriale nuk janë plotësisht funksionale dhe nuk sigurojnë mbrojtje të mjedisit.

Institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë mjaftueshëm për të mbrojtur ambientin nga operatorët ekonomik gjatë zhvillimit të aktivitetit minerar duke mundësuar që këta operatorë të operojnë pa zbatuar kriteret e kërkuara dhe pa ofruar siguri në terren. Procesi i dhënies së licencave dhe lejeve për aktivitete të veçanta nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, nuk ka ofruar siguri të mjaftueshme se plotësohen të gjitha kriteret gjatë licencimit të operatorëve ekonomik. Nuk ka koordinim mes palëve në aspektin e mbrojtjes së mjedisit, mungon programi i rehabilitimit dhe vazhdimi i licencave është bërë në mungesë të rikultivimit të zonave ku janë shfrytëzuar mineralet.

Procesi për dhënien e pëlqimeve dhe lejeve mjedisore nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit është përcjellë me disa mangësi në monitorimin e kushteve në pëlqimet mjedisore, vlefshmërinë e tyre dhe procesin e dhënies së lejeve mjedisore. Monitorimi i mbrojtjes së mjedisit nga kjo Ministri nuk është funksional sa duhet dhe inspektimi i shfrytëzuesve të mineraleve përcjellët me dobësi në zbatimin e dispozitave ndëshkuese dhe në monitorimin e operuesve ilegal.

Zbatimi i rekomandimeve të raportit “Administrimi i programit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike dhe vlerësimi i rezultateve”

Fokusi i këtij auditimi ishte që të vlerësohet niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit “Administrimi i programit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike” të publikuar në vitin 2017. Poashtu, është vlerësuar nëse institucionet përgjegjëse kanë analizuar informatat dhe rezultatet e programit me qëllim të rritjes së kapaciteteve të institucioneve shëndetësore publike në trajtimin e një numri më të madh të pacientëve dhe në kohë optimale.

Konkluzioni i auditimit është se nga katër rekomandimet e dhëna, dy prej tyre janë zbatuar kurse dy kanë zbatim të pjesshëm si dhe institucionet përgjegjëse nuk kanë ndërmarr ndonjë veprim lidhur me vlerësimin e rezultateve të këtij programi.

Fondi për Sigurime Shëndetësore ka bërë progres në zbatimin e rekomandimeve mirëpo, duhet të rris përpjekjet për zbatimin e rekomandimeve që kanë të bëjnë me përcaktimin e prioriteteve gjatë trajtimit të aplikacioneve nga Komisioni për Vlerësim Mjekësor dhe barazimet financiare me institucionet shëndetësore private ku janë trajtuar pacientët.

Bordi Ekzekutiv nuk ka rishikuar çmimorën së bashku me llojet e sëmundjeve nga viti 2017 edhe pse në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës në vazhdimësi janë bërë investime në infrastrukturë, burime njerëzore që kanë mundur të ndikojnë në rritjen e trajtimeve si dhe çmimet mund të kenë pësuar ndryshime.

Lidhur me vlerësimin e rezultateve për pacientët e trajtuar jashtë institucioneve shëndetësore publike përveç Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar nuk kanë ndërmarr ndonjë veprim lidhur me vlerësimin e rezultateve të këtij programi dhe nuk kanë raportuar. Për më tepër, edhe gjatë planifikimit të burimeve njerëzore dhe investimeve në infrastrukturë fizike nuk e kanë trajtuar nevojën për të ulur kërkesën për trajtim të pacienteve jashtë Institucioneve Shëndetësore publike. Mungesa e raportimeve dhe të dhënave i pamundëson institucionet shëndetësore në identifikimin e mundësive dhe zhvillimin e kapaciteteve brenda klinikave, me qëllim të reduktimit të kërkesave në periudha afatmesme dhe afatgjata.

“Raporti i vlerësimit të zbatimit të rekomandimeve për auditimet e performancës të vitit 2017”

Qëllimi kryesor i këtij raporti të vlerësimit ishte që t'i ofroj Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës një informacion lidhur me veprimet e ndërmarra nga institucionet publike për zbatimin e rekomandimeve të auditimit. Subjekt i Raportit të vlerësimit kanë qenë 166 rekomandime të dhëna në shtatë raporte të auditimit të performancës të publikuara në vitin 2017, ku kanë qenë të përfshira 35 institucione publike.

Raporti i vlerësimit, ka konstatuar se institucionet të audituara nuk janë angazhuar mjaftueshëm për të zbatuar rekomandimet e dhëna. Rezultatet e këtij vlerësimi tregojnë se zbatimi i rekomandimeve për auditime të performancës nuk është në nivel të kënaqshëm. Nga 166 rekomandime të dhëna, vetëm 36% e tyre janë zbatuar plotësisht, 10% janë në fazën finale të zbatimit, 13% kanë filluar zbatimin si dhe 10% e rekomandimeve nuk janë adresuar fare. Kurse për 31% të rekomandimeve entitetet nuk kanë dorëzuar informatat.

Gatishmëria e institucioneve që të përgatisin planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit ishte e kufizuar pasi vetëm katër (4) entitete nga 35 të audituara në vitin 2017 kanë dërguar planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ZKA-ja.

Mungesa e përgatitjes së planit të veprimit, mosgatishmëria e institucioneve që t'i përgjigjen vlerësimit dhe numri i ulët i zbatimit të plotë të rekomandimeve, tregojnë mungesën e përkushtimit të institucioneve publike për të përmirësuar performancën e tyre edhe rrjedhimisht menaxhimin me paranë publike.

Përveç mangësive, Raporti konstaton se janë ndërmarrë disa veprime nga entitetet dhe kjo mund të rezultojë në përmirësimin e aktiviteteve në fushën e gjyqësorit, zhvillimit ekonomik, arsimit dhe shëndetësisë.

“Efektiviteti i ndërlidhjes së arsimit dhe aftësisë profesionale me nevojat e tregut të punës”

Fokusi i auditimit ishte të vlerësohet efektiviteti i masave të ndërmarra nga institucionet publike për zhvillimin e njohurive dhe aftësisë profesionale dhe ndërlidhjen e tyre me nevojat e vazhdueshme të tregut të punës.

Raporti i auditimit ka theksuar se sistemi aktual i arsimit dhe aftësisë profesionale nuk është në gjendje t'i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të tregut të punës. Përkundër përpjekjeve për të ndërlidhur njohuritë dhe aftësitë profesionale me nevojat dhe kërkesat e vazhdueshme të tregut të punës, ky sistem është përcjellë me mangësi të shumta dhe kjo ka ndikuar që institucionet përgjegjëse të mos jenë të suksesshme në arritjen e qëllimit të synuar. Pavarësisht bashkëpunimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me akterët tjerë me qëllimin për të rishikuar kurrikulat e profileve të arsimit dhe aftësisë profesionale, e sidomos për të bazuar kurrikulat e rishikuara në zhvillimin e standardeve të profesionit, ky qëllim nuk është arritur. Po ashtu, mësimi praktik në punëtoritë e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësisë Profesionale dhe praktika profesionale në biznese janë realizuar me vështirësi dhe ngecje të mëdha. Institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të ofrojnë mundësi efektive për përvetësimin dhe zhvillimin e aftësisë dhe shkathtësisë dhe nuk kanë siguruar se janë krijuar kushtet e nevojshme në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisë Profesionale për zbatimin e formave duale të arsimit, kushte këto që mundësojnë realizimin e mësimi praktik në ambientet e shkollës dhe praktikës profesionale në biznese.

“Menaxhimi i Obligimeve Tatimore në Sistemet e Informacionit të Administratës Tatimore të Kosovës”

Ky auditim është **fokusuar** në Administratën Tatimore të Kosovës dhe kishte për qëllim vlerësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit të cilat mbështesin menaxhimin dhe administrimin e detyrimeve tatimore, për të siguruar që sistemet ofrojnë informacione të besueshme, të plota dhe të sakta.

Auditimi ka nxjerr ne pah se Administrata Tatimore e Kosovës ka disa mangësi, që ndërlidhen me kontrollet e aplikacionit, kontrollet e qasjes logjike në sisteme, si dhe me sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e sistemeve. Për rrjedhojë, ekziston rreziku që sistemet të ekspozohen ndaj rreziqeve të humbjes së integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave dhe disponueshmërisë së sistemeve.

Këto mangësi ndikojnë në paraqitjen e një pasqyrë jo të saktë dhe jo të plotë të llogarive të deklaratave tatimore, rreziqe të funksionimit të sistemeve të informacionit, humbje të integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave dhe rreziqe në sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e punës së sistemeve.

“Organizimi dhe menaxhimi i investimeve të teknologjisë së informacionit në institucionet publike”

Fokusi i këtij auditimi ishte që të vlerësohet zhvillimi qeverisjes së teknologjisë së informacionit dhe menaxhimin e investimeve në këtë fushë.

Auditimi ka nxjerrë në pah se, mungesa e organizimit dhe koordinimit mes institucioneve publike ka krijuar shpenzime të panevojshme në fushën e teknologjisë së informacionit. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka arritur të miratoj Strategjinë e Qeverisjes Elektronike e cila është hartuar nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Në mungesë të saj, Qeveria nuk ka një plan të prioriteteve për investime në fushën e TI-së.

Kjo situatë ka mundësuar që institucionet publike të zhvillojnë projekte paralele për nevojat e tyre, duke krijuar kështu shpenzime të panevojshme dhe investime të dyfishta. Fillimisht, nuk ka regjistër të projekteve të TI-së, si në nivel shtetëror ashtu edhe në nivel të organizatave buxhetore. Kjo e pamundëson identifikimin e saktë të gjendjes ekzistuese.

Institucionet publike kanë hyrë në investime pa bërë identifikimin e nevojave për projekte, analiza të mirëfillta të fizibilitetit për zhvillimin e projekteve si dhe pa bërë analiza paraprake dhe hulumtim të çmimeve të tregut. Po ashtu, ministrinë me departamentet e tyre dhe agjencitë nuk bashkëpunojnë për shfrytëzimin më optimal të infrastrukturës së TI-së. Edhe në komunat të cilat kanë qenë subjekt i auditimit kemi hasur në mangësi, duke filluar nga planifikimi strategjik, politikat dhe procedurat e TI-së si dhe në menaxhimin e investimeve në fushën e TI-së.

“Qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve në ASK”

Fokusi i këtij auditimi ishte të vlerësojë organizimin dhe qeverisjen e teknologjisë së informacionit, lidhur me kontrollet e sigurisë së të dhënave, kontrollet e aplikacioneve si dhe ruajtjen e integritetit të të dhënave në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Auditimi ka konkluduar se mënyra ekzistuese e menaxhimit të teknologjisë së informacionit nuk ka ofruar mjaftueshëm ambient të sigurt për ruajtjen e integritetit të të dhënave. Agjencia e Statistikave të Kosovës në përgjithësi nuk kishte vendosur mekanizmat e nevojshëm për kontrollet ku aktivitetet e TI-së janë zhvilluar, operuar, menaxhuar dhe mirëmbajtur.

Agjencia e Statistikave të Kosovës ka vështirësi në menaxhimin e resurseve të teknologjisë së informacionit, ka mungesë të vlerësimit adekuat të nevojave në fushën e TI-së, ndarje joadekuate të detyrave dhe përgjegjësisve të stafit të TI-së si dhe staf të pamjaftueshëm të TI-së. Po ashtu, menaxhimi i aktiviteteve të TI-së nuk është mjaftueshëm i bazuar në politika, procedura dhe procese të operimit. Trajtimi i incidenteve dhe problemeve bazohet në kërkesa të çastit si dhe mungon një regjistër i tyre. Nuk ka proces adekuat për menaxhimin e ndryshimeve, zhvillimit dhe testimit të aplikacioneve softuerike, si dhe mungon plani i vazhdimësisë së proceseve të punës në rast të ndonjë katastrofe natyrore, gabimi njerëzor apo dështimit të sistemeve të informacionit.

Auditimi gjithashtu ka treguar se Agjencia e Statistikave të Kosovës nuk ka mekanizma efektivë për të vlerësuar rrezikun e sigurisë së informacionit. Nuk kishte marrë hapat e mjaftueshme për t'u siguruar që informacioni nuk ekspozohet ndaj

palëve të paautorizuara si dhe nuk ka kontroll të mjaftueshëm mbi të dhënat që dalin/hyjnë nga/në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Mungojnë politikat që trajtojnë çështjet e sigurisë së informacionit.

1.3.4.Kontrolli i cilësisë

Qëllimi i auditimit është që të ofroj besim në cilësinë e raporteve financiare dhe menaxhimit financiar tek palët e interesit dhe publiku i gjerë.

Doracakët e auditimit me të cilët ZKA-ja operon, rregullojnë metodologjinë e kryerjes së auditimeve dhe ofrojnë informata dhe udhëzime të mjaftueshme për t'i ndihmuar auditorët gjatë procesit të auditimit që të punojnë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), parimet e INTOSAI, dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) si dhe udhëzimet të përshkuara në Kornizën e INTOSAI-t të Deklaratave Profesionale (KIDP).

Kontrolli i cilësisë përbëhet nga sisteme dhe praktika të krijuara për të siguruar që ISA-t të publikoj raporte që janë të përshtatshme për rrethanat, dhe në përputhje me standardet dhe legjislacionin në fuqi.

Në të gjitha auditimet që kryhen nga ZKA-ja, kontrolli i cilësisë kryhet dhe sigurohet në disa nivele, duke u nisur në nivelin e parë nga udhëheqësit e auditimit dhe pastaj në nivelin e dytë nga Ndihmësit e Auditorit të Përgjithshëm. Përveç kësaj, me qëllim të ngritjes së cilësisë së auditimeve në një nivel sa më të lartë, ZKA-ja ka të themeluar edhe Departamentin për Metodologji dhe Sigurimin e Cilësisë. Ky departament, i cili vepron në pajtim me SNISA-t 140 (Kontrolli i cilësisë), kryen rishikimin e auditimeve të realizuara, (gjatë dhe pas përfundimit të raportit bazuar në një metodologji të bazuar në rrezik) duke u siguruar që gjatë kryerjes së punës ekipet e auditimit kanë zbatuar plotësisht SNISA-t, metodologjinë e përcaktuar me Doracakun e Auditimeve të aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm dhe udhëzimet tjera.

Përzgjedhja e **auditimeve për rishikim** nga ky departament, gjatë vitit 2020 (për auditimet e sezonit auditues 2019/20) ka pasur parasysh **madhësinë, kompleksitetin e auditimeve**, si dhe është konsideruar **mbulueshmëria** e të gjitha ekipeve të auditimit në procesin e rishikimit të dosjeve të auditimit.

Për sezonin 2019/2020 janë kryer **34 rishikime të auditimeve të rregullsisë**, ku në fazën e planifikimit ishin kryer 27 rishikime, ndërsa 7 për fazën e ekzekutimit¹⁸.

Ndërsa për sezonin auditues 2020/21, këto kontrole janë zbatuar në të gjitha auditimet, për disa hapa të procesit të planifikimit, të cilat janë vlerësuar më

¹⁸ Numër më i ulët i rishikimeve këtë vit, ishte si pasojë e pandemisë COVID-19 dhe nevojës që stafi të angazhohet si pjesë e ekipeve e auditimit për të arritur që të gjitha auditimet të kryhen në afatin e përcaktuar me ligj dhe me cilësinë e kërkuar.

të rëndësishme dhe më me ndikim në auditim. Këto kontrole janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme dhe po vazhdojnë si të tilla. Ndërsa gjatë vitit 2021 planifikohet që të vazhdojë kontrolli i cilësisë, në përputhje me praktikën e ZKA-së, pra që të mbuloj auditimet më të mëdha dhe më komplekse, e duke përfshirë të gjitha ekipet e auditimit. Kjo i mundëson ZKA-së që të sigurohet se të gjitha ekipet e auditimit zbatojnë kërkesat e SNISA-ve, të metodologjisë së auditimit të definuar në doracakët përkatës dhe letrat e punës, si dhe kanë një qasje konsistente në auditim.

Sa i përket auditimeve të performancës, monitorimi dhe kontrolli i cilësisë është një proces që zbatohet në çdo auditim. Fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të auditimit janë subjekt i rishikimit në të gjitha nivelet menaxheriale. Rishikimi kolegjial për memorandumimin e parastudimit dhe draft-raportin e auditimit bëhet nga anëtarët e emëruar (auditorë me përvojë) brenda divizionit, përpara se draft - raporti të shqyrtohet nga menaxhmenti. Parastudimet dhe draft-raporti rishikohen në mënyrë sistematike, përmes diskutimeve brenda ekipit nga udhëheqësi i auditimit dhe menaxhmenti i lartë. Për disa nga temat janë angazhuar këshilltarë të jashtëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë (SNAO) dhe sipas nevojës apo specifikave të temës që auditohet angazhohen edhe ekspertë vendorë të fushave përkatëse.

1.4. Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse

Treguesi kryesor tek kjo fushë është: **menaxhimi financiar, pasuritë dhe shërbimet mbështetëse**. ZKA-ja, burim kryesor të financimit ka Buxhetin e Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, ZKA-ja pranon donacione dhe grante të ndryshme për të mbështetur aktivitetet dhe funksionet e saj. Ndërsa të hyrat që i realizon nga kryerja e auditimeve të projekteve të ndryshme, të financuara kryesisht nga donatorët, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2020, ZKA-ja ka bashkëpunuar me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë, siç janë Banka Botërore, USAID-i dhe Institucionet Supreme të Auditimit, që në forma të ndryshme kanë përkrahur ZKA-në në përmbushjen e synimeve strategjike.

1.4.1. Menaxhimi financiar

ZKA-ja bën përpjekje të vazhdueshme të zbatoj me përpikëri të gjitha rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë më menaxhimin financiar dhe kontrollin në Republikën e Kosovës.

Me Ligjin e Buxhetit Nr. 07/L-001, mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, ZKA-së i ishte ndarë buxheti fillestarë në vlerë 3,114,149€, që krahasuar me vitin 2019 ishte më i vogël për 7.3%. Kjo ulje, kryesisht ka të bëjë me zvogëlimin e buxhetit në kategorinë ekonomike “investime kapitale”, përkatësisht për projektin “softueri për menaxhimin e proceseve të auditimit”

pasi që një pjesë e projektit ishte realizuar dhe paguar në vitin 2019. Buxheti final i ZKA-së për vitin 2020 ishte 3,083.57€ ose 3.9% më i vogël se ai i vitit 2019.

Në vijim janë paraqitur ndarjet buxhetore dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike:

Pagat dhe mëditjet. Ndarja buxhetore për këtë kategori ekonomike ishte në shumën prej 2,077,454€. Kjo ndarje ishte më e vogël se kërkesa buxhetore dhe ZKA-ja ka informuar MF-në për këtë mungesë para miratimit të Ligjit të Buxhetit për vitin 2020. Prandaj në fund të vitit, Qeveria me Vendim ka ndarë mjetet shtesë në shumë prej 138,364.39€. Shuma e përgjithshme e shpenzuar në kategorinë e pagave ishte 2,215,818.38€. Krahasuar me vitin 2019, kjo shumë është për 4.2% më e madhe. Në këtë rritje të shpenzimeve, ndikim ka paraqitur shtimi i një (1) pozite të punës, llogaritja e rregullt vjetore e përvojës dhe promovimet e brendshme të puononjësve. Shpenzimi për këtë kategori ekonomike ishte 100%.

Mallrat dhe shërbimet. Për këtë kategori është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 691,695€ që përfshin edhe të hyrat vetanake. Me Ligjin Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020, ZKA-së nga kjo kategori i është reduktuar shuma prej 100,000€, kurse me Vendimin e Qeverisë Nr. 09/50 të datës 21.12.2020 është reduktuar edhe shuma prej 14,320.65€. Për shkak të reduktimeve të bëra me rishikimin e buxhetit dhe me qëllim të plotësimit të mungesës së mjeteve në kuadër të investimeve kapitale, ZKA-ja përmes Vendimit Nr. 400/2671 të datës 22.09.2020 ka bërë kërkesë për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike "mallra dhe shërbime" në kategorinë e "investimeve kapitale" në shumë të përgjithshme prej 13,423€. Buxheti final për kategorinë ekonomike "mallra dhe shërbime" në fund të vitit ishte 563,951€ duke përfshirë edhe të hyrat vetanake prej 20,000€. Krahasuar me vitin 2019, ndarja finale për këtë kategori ishte më e ulët për 15.6%. Në fund të vitit 2020, shpenzimi për këtë kategori ishte 523,018.32€ apo 93%.

Shërbimet komunale. Për kategorinë e Shërbimeve komunale është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 45,000€. Me Ligjin Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 është reduktuar shuma prej 16,420€. Me qëllim të mbulimit të shpenzimeve nga reduktimi i mjeteve si rrjedhojë e rishikimit buxhetor, ZKA-ja në procedurë të rregullt ka bërë transferimin e mjeteve nga kategoria ekonomike "mallra dhe shërbime" në "shpenzime komunale" në shumën prej 3,000€.

Ndarja finale buxhetore e kësaj kategorie ekonomike ishte në shumën 31,580€. Krahasuar me të vitin 2019, ndarja finale për këtë kategori ishte më e ulët për 10.3%. Në fund të vitit 2020, buxheti i shpenzuar ishte në vlerën 30,257.00€, ose në përqindje 96%.

Investimet kapitale. Për kategorinë e Shpenzimeve kapitale është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 300,000€. Ndërsa, me Ligjin Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020, ZKA-së iu ka reduktuar shuma prej 150,000€. Meqenëse projekti për softuerin e auditimit ishte i kontraktuar dhe në proces zbatimi, Qeveria e Kosovës me Vendimin Nr. 06/30 të datës 14.09.2020 ka ndarë mjete financiare në shumë prej 111,801€. Me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të kontraktuara për dy projekte kapitale dhe si rrjedhojë e reduktimit të mjeteve nga rishikimi buxhetor, ZKA-ja në procedurë të rregullt ka bërë transferimin e mjeteve nga kategoria ekonomike “mallra dhe shërbime” në “investime kapitale” në shumë prej 10,423€. Buxheti final për kategorinë ekonomike “Investime Kapitale” në fund të vitit ishte 272,224€, ndërsa buxheti i shpenzuar ishte në vlerën 272,217.98€, ose në përqindje 100%.

Tabela 8. Shpenzimi i buxhetit përgjatë tri vjetëve 2018-2020 (në EUR `000)

Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	% e shpenzimit
2020				
Buxheti i përgjithshëm	3,115	3,084	3,041	99%
Pagat dhe mëditjet	2,078	2,216	2,216	100%
Mallrat dhe shërbimet	692	564	523	93%
Shërbimet komunale	45	32	30	96%
Investimet kapitale	300	272	272	100%
2019				
Buxheti i përgjithshëm	3,358	2,966	2,895	98%
Pagat dhe mëditjet	2,098	2,125	2,125	100%
Mallrat dhe shërbimet	723	660	615	93%
Shërbimet komunale	50	35	33	95%
Investimet kapitale	487	147	122	83%
2018				
Buxheti i përgjithshëm	2,791	2,744	2,697	98%
Pagat dhe mëditjet	2,020	2,003	2,003	100%
Mallrat dhe shërbimet	651	651	613	94%
Shërbimet komunale	45	36	30	89%
Investimet kapitale	75	54	51	95%


19 Në këtë vlerë nuk janë përfshirë mjetet e projektit të Bankës Botërore.

Grafiku 9 paraqet pasqyrën e shpenzimit të buxhetit të ZKA-së gjatë vitit 2020. Shpenzimet e realizuara tregojnë se pagat dhe mëditjet vazhdojnë të kenë shpenzimin më të madh të buxhetit që ka vlerën e 73%, derisa mallrat dhe shërbimet janë në përqindje prej 17%. Kategoria e shpenzimeve komunale është në shumën e shpenzimeve prej 1%, kurse ajo e investimeve kapitale në shumë prej 9%.


Krahasuar me vitet paraprake, kategoria e pagave dhe meditjeve dhe ajo e shpenzimeve komunale vazhdojnë të jenë në përqindje të njëjtë të shpenzimit.

Gjate vitit 2020 kategoria ekonomike për mallra dhe shërbime ka një ulje të shpenzimeve si rrjedhojë e pandemisë COVID-19, kurse te kategoria ekonomike e Investimeve kapitale, ka rritje të shpenzimeve si rezultat i zbatimit të projektit "softueri për menaxhimin e proceseve të auditimit".


Grafiku 9. Trendi i shpenzimeve kryesore (%)



Grafiku 10. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive ekonomike



Grafiku 10. Shpenzimet kryesore në kategorinë Mallra dhe Shërbime



Grafiku 10 pasqyron shpërndarjen e shpenzimeve të kategorisë ekonomike Mallrat dhe Shërbimet.

- Shpenzimet më të mëdha në këtë kategori, prej 33%, vazhdojnë të jenë ato të qirasë së objektit. ZKA-ja aktivitetin e saj e kryen në një objekt privat. Një zgjidhje e përhershme në ndonjë objekt në pronësi publike do të ulte ndjeshëm koston e këtij aktiviteti;
- Pajisjet dhe furnizimet për zyrë përbëjnë 16 % të shpenzimeve të kategorisë. Këtu përfshihen pagesat për blerje të pajisjeve dhe furnizime të tjera për nevoja të ZKA-së për vitin 2020.
- Mirëmbajtja dhe sigurimi fizik i ndërtesave, pajisjeve të TI dhe automjeteve, përfshinë 16% të shpenzimeve.
- Shërbimet kontraktuale përbëjnë 9% të shpenzimeve. Këtu përfshihen përkthimet e raporteve të auditimit, shërbimet e transportit, platformat elektronike për trajnime dhe disa kontrata për shërbime të veçanta.
- Shërbimet intelektuale këshillëdhënëse përbëjnë 6% të shpenzimeve. Këtu përfshihet auditimi i kontraktuar, angazhimet e ekspertëve në auditim dhe pagesat e anëtarëve të jashtëm të Komitetit të auditimit.
- Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit për punë audituese dhe për udhëtimet jashtë vendit përfshijnë 5% të shpenzimeve;
- Shpenzimet për karburante për nxemje, gjenerator dhe automjete zyrtare përfshijnë 5% të shpenzimeve;

1.4.2.Shërbimet mbështetëse

Në ZKA funksionojnë edhe shërbimet mbështetëse që kryejnë aktivitete në kuadër të Shërbimeve të përbashkëta, Teknologjisë Informative dhe Prokurimit.

Shërbimet e përbashkëta. Në përputhje me strategjinë dhe objektivat e ZKA-së, Departamenti për Shërbime të Përbashkëta përmes divizioneve përkatëse ofrojnë shërbime administrimin për personelin e ZKA-së. Divizionet përkatëse të këtij Departamenti janë: Divizioni për Logjistikë, Divizioni për Administrim të dokumenteve zyrtare dhe Divizioni për përkthime.

Në kuadër të Divizionit për logjistikë, janë bërë avancime në rregullativën për menaxhimin e pasurive jo financiare. Përmes sistemeve elektronike, E-Pasuria dhe SIMFK është bërë regjistrimi i të gjitha pasurive të blera gjatë vitit 2020 në sistemet përkatëse, barkodimi i tyre, inventarizimi, vlerësimi si dhe tjetërsimi i pasurive jashtë përdorimit.

Divizioni për administrimin e dokumenteve zyrtare, në bashkëveprim me Departamentin e Teknologjisë Informative ka vazhduar me menaxhimin/arkivimin elektronik të dokumenteve zyrtare. Përmes platformës elektronike, auditorët kanë qasje në dokumentet e arkivuara të cilat janë të nevojshme për punët vijuese në auditim.

Divizioni për përkthime ofron shërbimin e përkthimit të dokumenteve zyrtare në gjuhën angleze dhe serbe si dhe përkthimin e drejtpërdrejt në takimet dhe punëtoritë e organizuara nga ZKA.

Si shkak i stafit të limituar në kuadër të këtij divizioni në njërin anë si dhe volumit të madh të nevojave për përkthim të dokumenteve në anën tjetër, gjatë vitit 2020 ZKA-ja ka pasur të kontraktuar një operator të jashtëm për përkthimin e raporteve të auditimit.

Teknologjia Informative. Përhapja e COVID-19, ka ndikuar shumë punën e Departamentit të TI-së në ZKA. Puna në distancë ka sjellë ndryshime për Departamentin e TI-së sepse është rritur ngarkesa e punës në Infrastrukturën e TI-së si dhe ka pasur shtim të konsiderueshëm të kërkesave për mbështetje të shfrytëzuesve. Në të njëjtën kohë kjo mënyrë e punës ka rezultuar edhe në kërkesa të reja për mirëmbajtjen e sigurisë së sistemeve dhe bazës së të dhënave. Për nevoja të sistemeve të TI-së është shtuar numri i softuerëve për mbikëqyrje dhe mirëmbajtje të sigurisë së dhënave.

Gjatë muajve të verës 2020 është përgatitur infrastruktura për Sistemin për Menaxhimin e Auditimit (SITA). Gjithë puna e zhvillimit të softuerit dhe trajnimit është zhvilluar nga distanca.

Prokurimi. Në kuadër të aktiviteteve të prokurimit gjatë vitit 2020, kryesisht është punuar sipas Planit Vjetor të Prokurimit të miratuar në përputhje me Ligjin përkatës për Buxhetin. Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar gjithsejtë 63 aktivitete të prokurimit, të cilat kryesisht kanë qenë furnizime dhe kryerje të shërbimeve.

1.4.3. Menaxhimi i pandemisë COVID-19

ZKA-ja që në shfaqje të pandemisë ka ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e masave dhe udhëzimeve të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse. Me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të pandemisë COVID-19, Auditori i Përgjithshëm, ka themeluar një Komision të veçantë për zbatimin e masave përkatëse dhe i cili raporton rregullisht për situatën pandemike në institucion dhe që kujdeset për aplikimin e masave mbrojtëse kundër pandemisë.

Pavarësisht këtyre masave preventive, gjatë vitit 2020, një numër i punonjësve të ZKA-së ishin infektuar dhe kishin marrë trajtimin e nevojshëm, pas të cilit i janë kthyer aktivitetit të rregullt. Kjo ka ndikuar edhe në mbarvajtjen e punës audituese dhe realizimin me kohe të planit të punës.

1.5. Menaxhimi i Burimeve njerëzore

Treguesit kryesorë të kësaj fushë janë: **menaxhimi i burimeve njerëzore** dhe **zhvillimi profesional**.

1.5.1. Burimet njerëzore

Shërbimi i burimeve njerëzore është një ndër funksionet kryesore të një institucioni të lartë të auditimit, i cili poashtu ka ndikim në tërë personelin e ZKA-së. Gjatë vitit 2020, ZKA-ja ka ndërmarrë një sërë aktivitete që ndërlidhen me marrëdhënien e punës, zhvillimin profesional, mirëqenien në punë dhe vlerësimin e performancës

së punonjësve të saj. Po ashtu, është siguruar që secili punonjës të ketë kushtet për punë dhe se shërbimet janë dhënë në mënyrë efektive dhe efikase.

Në vitin 2020, ZKA-ja ka bërë ndarjen e burimeve të nevojshme njerëzore për përmbushjen e planit operativ vjetor dhe atij strategjik afatgjatë sipas kufijve të përcaktuar më Ligjin e Buxhetit. Në këtë kontekst, dhe në përputhje me këtë Ligj, ZKA-ja kishte të miratuara 173 pozita të punës. Në fund të vitit 2020, kishte gjithsej 171 punonjës, prej tyre 142 ose 83% personel auditues, përfshirë pozitat drejtuese, ndërsa pjesa tjetër prej 29 punonjësve apo 17% janë punonjës të shërbimeve mbështetëse në auditim dhe të shërbimeve të tjera profesionale dhe administrative.

Në plotësimin e vendeve të lira tëpunës, përveç tjerash ZKA, ka krijuar kushte dhe hapësirë për angazhimin e personave me nevoja të veçanta. Në proceset e zhvilluara me sukses dhe për herë të parë kemi rekrutuar një punonjës nga kjo kategori.

Rekrutimet. Gjatë vitit 2020, ZKA-ja ka angazhuar tre punonjës të rinj, në marrëdhënie të rregullt pune të cilët kanë zëvendësuar punonjësit që kanë liruar vendet e punës në ZKA.

Gjatë vitit 2020, 14 punonjës të ZKA-së kanë përfituar nga proceset e brendshme të promovimit në detyrë, kryesisht në fushën e auditimit.

ZKA-ja ka organizuar edhe një proces të angazhimit të auditorëve të përkohëshëm (për tre muaj), me qëllim të përkrahjes në kryerjen e auditimeve të rregullsisë për shkak të mungesave të theksuara të punonjësve të shkaktuara nga situata pandemike COVID-19.

Tabela 9 paraqet të dhënat rreth punonjësve, ku përfshihet numri i përgjithshëm i punonjësve, përqindja e gjinisë femërore, moshë mesatare në ZKA, numri i punonjësve nga komunitetet si dhe përqindja e lëvizjeve/largimeve të punonjësve në vitin 2020. Në krahasim me vitin paraprak, numri i punonjësve në ZKA, përkundër lëvizjeve ka mbetur i njëjtë. Numri i përgjithshëm i punonjësve ende mbetet sfidë, për të mbuluar të gjitha aktivitetet e ZKA-së, sidomos ato në auditim.

Struktura gjinore ka pasur një ndryshim prej 0.6% në favor për gjininë mashkullore. Në këtë ndryshim ka ndikuar lëvizja e punonjësve përgjatë vitit. Megjithatë kemi arritur të mbajmë një barazi gjinore, që është representative për të dy gjinitë. Përfaqësimi i gjinisë femërore nëpër pozita drejtuese është mjaft i kënaqshëm.

Moshë mesatare e punonjësve ka një ulje të lehtë nga viti i kaluar, 78% e punonjësve të ZKA-së janë të moshës së mesme prej 31 deri në 50 vjet, të moshës prej 51 deri në 65 vjet janë 17%, kurse të moshës nën 30 vjet janë 5% e punonjësve.

Numri i punonjësve nga komunitetet nuk ka pësuar ndryshim, edhe përkundër përpjekjeve tona për të tërhequr më shumë kandidatë nga komunitetet, interesimi nga kjo kategori mbetet ende i vogël. Lëvizja e punonjësve është e

njëjtë me vitin paraprak dhe është në shifrat prej 1.75% për vitin 2020. Vërehet një trend linear i largimit të punonjësve ndër vite. Gjatë vitit 2020 dy punonjës kanë lëshuar ZKA-në dhe një tjetër është pensionuar.

Tabela 9. Ndryshimet në personelin e ZKA-së, përgjatë tri viteve të fundit

Viti	Nr. i personelit në fund të vitit (numër)	Personeli femëror (%)	Mosha Mesatare (vite)	Personel nga komunitetet (numër)	Lëvizja e personelit (%)
2020	171	52.6	41.7	4	1.75
2019	171	53.2	42.2	4	1.75
2018	167	50.9	40.4	4	1.82

Tabela 10 prezanton strukturën gjinore në pozitat menaxheriale në ZKA. Këtu përfshihen, nivelet drejtuese, niveli i mesëm dhe pozitat e udhëheqësve të ekipeve të auditimit²⁰. Në vitin 2020, numri i femrave në pozita menaxheriale është pothuajse i balancuar.

Tabela 10. Pozitat drejtuese sipas gjinisë në të gjitha funksionet

Viti	Gjithsej femra në pozita udhëheqëse (numër)	Përqindja %	Gjithsej meshkuj në pozita udhëheqëse (numër)	Përqindja %
2020	35	49	37	51
2019	39	53	34	47
2018	32	44	40	54

1.5.2. Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit

Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore mbetet një ndër prioritetet kryesore të ZKA-së, pasi që me zhvillimin e këtyre kapaciteteve kontribuohet në cilësi më të mirë, profesionalizëm më të lartë dhe qasje më të organizuar ndaj punës. Zhvillimi profesional dhe aftësia në rritje e punonjësve të ZKA-së për të përmbushur kërkesat dhe kriteret e vendosura nga INTOSAI paraqet bazë për të vlerësuar performancën dhe pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për ISA-të.

Gjatë vitit 2020 është funksionalizuar Departamenti për Komunikim dhe Zhvillim Profesional, përmes së cilit planifikohen aktivitetet e zhvillimit profesional dhe trajnimeve. Aktivitetet e trajnimeve janë zhvilluar duke u bazuar në planin vjetor të trajnimeve.

Pavarësisht gjendjes së krijuar për shkak të pandemisë, viti 2020 ka qenë mjaftë intensiv sa i përket aktiviteteve që ndërlihen me zhvillimin profesional dhe trajnimin. Kjo për shkak të përditësimit të doracakëve të auditimit dhe letrave

²⁰ Pozita e udhëheqësit të ekipit është me mandat njëvjeçar dhe është subjekt i ndryshimeve për çdo vit, varësisht nga nevojat e Planit Vjetor të Auditimit.

të punës sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira si digjitalizimit të procesit të punës audituese përmes sistemit elektronik për menaxhimin e auditimit- SITA.

Përveç, trajnimeve të brendshme, punonjësit e ZKA-së kanë përfituar edhe nga trajnimet e ofruara nga institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare si dhe kanë marrë pjesë në shumë punëtori ndërkombëtare.

Programi "Udhëheqësit e rinj të Institucioneve Supreme të Auditimit". Në dhjetor 2020, një punonjëse e ZKA-së ka përfunduar me sukses programin dy vjeçar "Udhëheqësit e rinj të Institucioneve Supreme të Auditimit" të organizuar nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t".

Certifikimi i auditorëve të performancës. Përmes bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë është zhvilluar trajnimi profesional për të gjithë auditorët e performances në ZKA. Programi i filluar në vitin 2019, është finalizuar në janar të vitit 2020. Në fund të programit, të gjithë auditorët iu kanë nënshtruar testit me shkrim, i cili është përgatitur bashkërisht me ekspertët e SNAO-s. Tetëmbëdhjetë auditorë të performancës, përfshirë edhe tre menaxherë kanë marrë pjesë dhe e kanë kryer me sukses programin e trajnimit, si dhe janë pajisur me certifikata të nënshkruara nga Auditori i Përgjithshëm i Kosovës dhe ai i Suedisë. Përkrahja e SNAO-s është realizuar edhe përmes këshillëdhënies dhe punës praktike, në raste të caktuara.

Trajnimet për metodologjinë e përditësuar. Në kuadër të Projektit të Binjakëzimit "Fuqizimi i mëtejshëm i ndikimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës" dhe me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të brendshme për zbatimin e metodologjisë së përditësuar të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë, gjatë vitit 2020 është bërë përditësimi i Doracakut të auditimeve të rregullësisë në qasjen e kombinuar të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë.

Me qëllim të familjarizimit të stafit me kërkesat e doracakut dhe letrave të punës të përditësuar janë mbajtur trajnime intensive online. Realizimi i këtij programi të trajnimit është ndarë në tri pjesë/module, që përfshijnë zbatimin e metodologjisë për planifikimin e përgjithshëm dhe detaj në auditim; fazën e ekzekutimit dhe raportimin e auditimit. Trajnimet për modulën e parë janë mbajtur gjatë muajve shtator dhe tetor, ndërsa trajnimet për modulet e tjera do të mbahen në muajin janar dhe mars të vitit 2021. Pas përfundimit të trajnimeve, i gjithë stafi auditues do t'i nënshtrohet testimit. Po ashtu, në kuadër të këtij projekti janë mbajtur edhe trajnime të veçanta për ekipet e përzgjedhura si pilot dhe për personelin e departamentit për metodologji dhe cilësi.

Projekti i binjakëzimit, financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Institucioni Suprem i Auditimit të Polonisë.

Trajnimet për përdorimin e sistemit elektronik të auditimit (SITA). Me digjitalizimin e auditimit, përmes sistemit elektronik të auditimit (SITA) dhe me qëllim që të sigurohet përdorimi efektiv i tij, i gjithë personeli auditues në muajin tetor ka ndjekur trajnimet intensive online për të mundësuar kalim më të lehtë në metodën e re


të punës. Gjatë trajnimeve auditorët kanë pasur mundësi të ndjekin materialet, udhëzimet dhe videot e përgatitura, të realizojnë ushtrimet praktike dhe të diskutojnë me trajnerët apo me njëri tjetrin. Të gjithë përdoruesit e sistemit janë certifikuar para përdorimit të tij.

Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP). Sipas marrëveshjeve me shoqatat profesionale për vijimin e trajnimeve në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP) të gjithë auditorët e ZKA-së i janë nënshtruar mbajtjes së orëve për tema të caktuara të EVP-ve, me ç'rast edhe janë pajisur me certifikatat për pëmbushjen e EVP-ve. Marrëveshja me shoqata profesionale në ofrimin e sesioneve trajnuese për të gjithë auditorët për forcimin e mëtejme të kompetencës në punë është arritur në vitin e kaluar. Sipas marrëveshjes vet auditorët janë përcaktuar për temat e trajnimeve të cilat kanë qenë në interesin e tyre profesional.

Trajnimi "Prokurimi sipas rregullave të Bankës Botërore". Në kuadër të projektit me Bankën Botërore, në muajin maj, dhjetëra auditorë të ZKA-së kanë ndjekur trajnimin "online" katër ditor me temën "Prokurimi sipas rregullave të Bankës Botërore". Trajnimi ka pasur për qëllim dhënien e informacioneve të mjaftueshme dhe të qarta sa i përket rregullave dhe mënyrës se si duhet të auditohen projektet e Bankës Botërore.

Trajnimi për zhvillimin e aftësive në prezantim publik. Në kuadër të projektit "Promovimi i rolit të Auditorit të Përgjithshëm / ZKA-së në Kosovë" personeli drejtues i ZKA-së ka ndjekur programin e trajnimit, që kishin për qëllim zhvillimin e aftësive të komunikimit në paraqitjet publike, rrjetet sociale dhe shkrimin e komunikatave. Projekti është mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë Holandeze, Rrjeti të Gazetarisë Hulumtuese në Ballkan- BIRN Kosova, si dhe ACDC-ja.

Fotogaleria 1. Trajnimet



1. Trajnimi për përdorimin e SITA-s
2. Trajnimi "Prokurimi sipas rregullave të BB-së"
3. Trajnimi për prezantimin publik me BIRN

1.6. Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit

ZKA-ja ka vazhduar të mbajë një komunikim të frytshëm me palët e interesit, përmes platformave online të komunikimit.

Gjatë vitit 2020, ZKA-ja ka hartuar²¹ **Strategjinë e Komunikimit 2020-2022**, si mjet thelbësor për promovimin e praktikave më të mira, llogaridhënies dhe transparencës. Përmes kësaj strategjie ZKA-ja synon të:

- Promovojë rolin kushtetues të ZKA-së dhe të rris vetëdijesimin publik për rezultatet e auditimit;
- Rris llogaridhënien në sektorin publik përmes bashkëpunimit intensiv me Parlamentin;
- Rris ndikimin e punës audituese si dhe të komunikojë dhe marrë pjesë aktive në aktivitete ndërkombëtare.

²¹ Procesi i hartimit të Strategjisë së Komunikimit është mbështetur nga ekspertë të Institutit Suprem të Auditimit të Polonisë, përmes projektit të binjakëzimit.

ZKA-ja ka zhvilluar më tutje qasjen gjithëpërfshirëse, duke qenë nikoqire dhe pjesëmarrëse në shumë takime, punëtori e konferenca brenda dhe jashtë vendit. Përderisa në rrafshin kombëtar është forcuar më tej partneriteti me komisionet parlamentare dhe organizatat e shoqërisë civile.

Ndërsa, **aktiviteti ndërkombëtar** ka kulmuar me anëtarësimin e ZKA-së me të drejta të plota në Organizatën Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI), pas anëtarësimit në vitin 2019 në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

1.6.1.Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin

ZKA-ja gjatë vitit 2020 ka intensifikuar komunikimin dhe bashkëpunimin me Kuvendin e Republikës së Kosovës, përmes punës me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe Komisionin për Buxhet dhe Transfere (KBT).

Auditori i Përgjithshëm ka prezantuar në seancë plenare gjetjet dhe rekomandimet e Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2019, me ç'rast Kuvendi ka miratuar rekomandimet e KMFP-së për t'i kërkuar Qeverisë së Kosovës që të zbatojë të gjitha rekomandimet e dala nga Raporti Vjetor i Auditimit. Gjithashtu, në Kuvend është miratuar edhe Raporti Vjetor i Performancës i ZKA-së për vitin 2019.

Në vazhdimësi, ZKA-ja ka përgatitur për KMFP-në dhe KBT-në informatat e nevojshme dhe përmbledhjet për raportet e auditimeve të kryera, si dhe u ka ofruar deputetëve informatat dhe këshillat e nevojshme në lidhje me raportet e auditimit që diskutohen në komisionet parlamentare.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar 24 raporte të auditimit, prej tyre 14 të ministrive, 8 të Ndërmarrjeve Publike, Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2019 si dhe Raportin Vjetor të Performencës së ZKA-së për vitin 2019. Gjithashtu, të dy komisionet parlamentare kanë shqyrtuar raportin vjetor të performancës të ZKA-së për vitin 2019.

Sipas nevojës, AP-ja ka mbajtur takime të veçanta me kryetaren e Kuvendit të Kosovës dhe drejtuesit dhe anëtarët e KMFP-së dhe KBF-së.

Fotogaleria 2. Bashkëpunimi me Kuvendin



1. Auditori i Përgjithshëm, prezanton në Kuvend, Raportin Vjetor të Auditimit për vitin fiskal 2019
2. Prezantimi i RVA-së në KMFP
3. Prezantimi i RVP për vitin 2019, në KBT

Bashkëpunimi me përfaqësuesit e lartë të institucioneve publike të vendit ka vazhduar përmes komunikimit të rregullt dhe takimeve sipas nevojës, ku janë prezantuar çështjet kryesore të auditimit për vitin 2019 dhe progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit. Brenda kompetencave institucionale, kujdes i veçantë i është kushtuar bashkëpunimit profesional me Thesarin. Komunikimi i rregullt ndërmjet dy institucioneve ka bërë që të evidentohen me kohë dhe të shmangen një sërë gabimesh në Raportimin Financiar të OB-ve.

AP-ja, përmes Njësisë së ZKA-së për Luftimin e Mashtrimit ka pasur bashkëpunim të rregullt institucional edhe me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit, si me: **Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit**, duke e informuar në lidhje me 55 raste indikative me elemente të veprave penale, të cilat janë hasur gjatë punës audituese; **Agjencinë Kundër Korrupsionit**, duke ofruar informata shtesë dhe sqarime sipas nevojës lidhur me trajtimin e gjetjeve në raportet e auditimit; dhe **Policinë e Kosovës**, duke i ofruar të dhëna dhe dokumente relevante, të siguruar në proceset e auditimit për rastet e caktuara, të cilat trajtohen nga hetuesia. Në raport me organet e drejtësisë dhe organizmat

përkatëse për luftimin e korrupsionit, ZKA-ja vepron në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me legjislacionin kombëtar të fushës penale. Poashtu, AP-ja ka kultivuar komunikim konstruktiv ndër-institucional edhe me **Institucionin e Avokatit të Popullit**.

1.6.2. Komunikimi me Mediat, Qytetarët, Organizatat e Shoqërisë Civile, Donatorët dhe akterë të tjerë

Krahas zhvillimeve të tjera gjatë vitit 2020, është thelluar partneriteti me media dhe komunikimi me qytetarë. Ky komunikim është avancuar edhe përmes takimeve të ndryshme si dhe prezantimit publik të raporteve të auditimit të performancës, konferencave për media si dhe ligjëratave të mbajtura nga Auditori i Përgjithshëm për gazetarët e rinj dhe studentë të universiteteve publike dhe kolegjeve private.

Gjatë vitit 2020 janë prezantuar katër raporte të auditimit të performancës: "Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018–2020 në sektorin e arsimit dhe të infrastrukturës" - Shkurt 2020; "Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjellësit"- Shkurt 2020; "Zbatimi i rekomandimeve të raportit 'Fondi Zhvillimor' dhe efektet e fondit" - Mars 2020; dhe "Projektet e financuara nga grantet e DEMOS-it" - Maj 2020.


Po ashtu rendësi e veçantë i është kushtuar vënies në dispozicion të informatave të kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile, medieve dhe qytetarëve si dhe avancimit dhe modernizimit të komunikimit në rrjete sociale përmes fushatave vetdijësuese të ndryshme.

Përmes paraqitjeve publike, puna dhe rezultatet e auditimit kanë qenë më afër publikut, me ç' rast është vërejtur rritje e prezencës së ZKA-së në media, duke u botuar mbi 1.070 artikuj për raportet e auditimit dhe aktivitetet e Auditorit të Përgjithshëm dhe ZKA-së.

Edhe ueb faqja e ZKA-së, si burimi kryesor i informacionit është përditësuar në vazhdimësi duke i ofruar qytetarëve qasje në të dhëna për raportet e auditimit ku brenda vitit janë regjistruar mbi 197,964 vizitorë. Po ashtu, ZKA-ja është vlerësuar në mesin e institucioneve që kanë treguar praktikë të shkëlqyeshme të përkthimit në gjuhët zyrtare duke respektuar Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Ky vlerësim është bërë nga Zyra e Komisionerit për gjuhët (ZKGJ), në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE). Ndarja e çmimit "Praktika më e mirë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve", është bërë në bazë të monitorimit të përdorimit të gjuhëve zyrtare në ueb faqet zyrtare të institucioneve përkatëse duke përfshirë edhe rrjetet sociale.

Edhe komunikimi me publikun përmes rrjeteve sociale është avancuar, me ç' rast është hapur faqja zyrtare në rrjetin social "Twitter". Ndërsa, gjatë vitit janë përgatitur edhe fushata vetdijësuese si ajo e 17 Vjetorit të ZKA-së dhe Sukseset përtej sfidave me rastin e përmbylljes së 2020-tës.

Fotogaleria 3. Takimet me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Mediat



1. Konferenca për media në fund vit
- 2 dhe 3. Prezantimet publike të raporteve të auditimit
4. Ceremonia e ndarjes së çmimit "Praktika më e mirë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve"

Me qëllim të rritjes së ndikimit të auditimit të jashtëm dhe rritjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm nga komunat e Kosovës janë mbajtur **dhjetë debate** në të cilat ka marrë pjesë Menaxhmenti i ZKA-së, ku në prezencë të kryetarit të komunës, të këshilltarëve komunal, të përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të mediave është diskutuar për progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

- Në kuadër të projektit “Promovimi i rolit të Auditorit të Përgjithshëm/ZKA-së në Kosovë”, i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës/Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës dhe BIRN Kosova, janë mbajtur pesë debate në komunat: Dragash, Lipjan, Vushtrri, Mitrovicë e Veriut dhe Viti.
- Në kuadër të projektit “Mbështetja e shoqërisë civile për të rritur mbikëqyrjen publike dhe llogaridhënien e institucioneve publike të Kosovës” i mbështetur nga Zyra e Jashtme e Komonuelthit përmes Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, dhe BIRN Kosova, janë mbajtur **pesë debate** në komunat: Kamenicë, Ferizaj, Shtime, Rahovec dhe Pejë.

Fotogaleria 4. Debatet publike në Komuna



1. *Debati në Komunën e Mitrovicës së Veriut*
2. *Debati në Komunën e Vushtrisë*
3. *Debati në Komunën e Pejës*
4. *Debati në Komunën e Rahovecit*

ZKA-ja ka pasur bashkëpunim të mirë edhe me institucionet e tjera vendore. Edhe gjatë vitit 2020 janë shtuar aktivitetet për përfshirjen e institucioneve akademike

e shkencore për avancimin e kualifikimeve profesionale të auditorëve. Auditorët kanë ndjekur edukimin e vazhdueshëm profesional të auditorëve. Ndërkaq, Auditori i Përgjithshëm ka mbajtur ligjerata me studentë e Universiteteve Publike dhe Kolegjeve Private me temën “Auditimi i jashtëm në Kosovë, të arriturat, sfidat dhe ndikimi i auditimit për menaxhim më të mirë të financave publike”.

17 vjetori i Themelimit të ZKA-së. Me aktivitete simbolike Zyra Kombëtare e Auditimit në muajin tetor të vitit 2020 ka shënuar shtatëmbëdhjetë vjetorin e themelimit. Në kuadër të këtyre aktiviteteve është mbajtur edhe një takim online si dhe janë ndarë mirënjohje për tridhjetë punonjës të cilët kanë mbushur 10 vjet punë në ZKA.

1.6.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere, marrëveshjet bilaterale, takimet e vizitat

Edhe pse nga marsi i vitit 2020 ishim të detyruar të punojmë në rrethana të jashtëzakonshme dhe me masa të shtuara me qëllim të mbrojtjes nga virusi dhe parandalimit të shpërndarjes së tij, ZKA-ja ka vazhduar ta ketë në fokus të veçantë bashkëpunimin ndërkombëtar.

Pas anëtarësimit të ZKA-së në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), aktiviteti ndërkombëtar ka kulmuar me anëtarësimin e ZKA-së me të drejta të plota në Organizatën Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI). Integrimi i ZKA-së në organizatat ndërkombëtare, përbën suksesin më të madh në historinë e auditimit të jashtëm, të sektorit publik të Republikës së Kosovës.

ZKA-ja kishte aplikuar për anëtarësim në INTOSAI me 8 maj të vitit 2018, dhe pas një procesi të gjatë lobues në arenën ndërkombëtare, në takimin e 72-të të Bordit drejtues, të mbajtur me 23 dhe 24 shtator 2019 u konfirmua vendimi për anëtarësim, me të cilin një ditë më vonë u njoftua Kongresi i 23-të i INTOSAI-t, i cili u mbajt në Moskë. Ky vendim hyri në fuqi me 1 janar 2020, prej kur ZKA-ja u bë anëtare me të drejta të plota e INTOSAI-t.

Menjëherë pas kësaj, me 24 shkurt 2020, ZKA-ja, kishte aplikuar për anëtarësim në EUROSAI. Bordi Drejtues i Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI), në takimin e vet të 52-të, të mbajtur me 12 nëntor 2020, ka miratuar me shumicë votash anëtarësimin me të drejta të plota të ZKA-së në këtë organizatë.²²

Si anëtare e INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, ZKA-ja synon të jap kontribut dhe të promovojë përveç tjerash qeverisjen e mirë, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies si dhe ngritjen e kompetencës profesionale në fushën e auditimit publik.

²² Zyra Kombëtare e Auditimit në muajin prill të 2021 mori pjesë në Kongresin e XI-të të EUROSAI, me ç'rast hyri në fuqi e drejta për të votuar si anëtar me të drejta të plota.

Konferenca Ndërkombëtare “Domethënia dhe rëndësia e anëtarësimit në INTOSAI: ndikimi dhe përfitimet për Institucionet Supreme të Auditimit”.

Me rastin e pranimit të ZKA-së në INTOSAI, në muajin shkurt 2020, ZKA-ja ka organizuar Konferencën Ndërkombëtare “Domethënia dhe rëndësia e anëtarësimit në INTOSAI: ndikimi dhe përfitimet për Institucionet Supreme të Auditimit”.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të lartë nga Institucionet Supreme të Auditimit nga Suedia, Emiratet e Bashkuara Arabe, Polonia, Turqia, Finlanda, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, nga Gjykata Evropiane e Auditorëve, si dhe përfaqësues nga INTOSAI. Po ashtu, në konferencë morën pjesë edhe udhëheqës të lartë të institucioneve publike të Kosovës, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, media dhe të organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve.

Me rastin e pranimit të ZKA-së në INTOSAI është publikuar botimi i parë i librit “Integrimi Ndërkombëtar i Zyrës Kombëtare të Auditimit”. Ky publikim²³ në shenjë mirënjohjeje u dedikohet të gjithë individëve dhe institucioneve, që u angazhuan dhe përkrahën ZKA-në në kauzën e saj legjitime, për t’u integruar denjësisht në familjen globale të Institucioneve Supreme të Auditimit.



Konferenca Domethënia dhe rëndësia e anëtarësimit në INTOSAI: ndikimi dhe përfitimet për Institucionet Supreme të Auditimit

23 Libri përfshin disa nga zhvillimet e rëndësishme të ZKA-së deri te anëtarësimi në INTOSAI.

Projektet e Bashkëpunimit me ISA-t

Në rrethanat e pandemisë, përmes platformave të ndryshme elektronike ka vazhduar puna online duke realizuar kështu në tërësi planin e aktiviteteve në kuadër të **Projektit të Binjakëzimit** të zbatuar nga Institucioni Suprem i Auditimit i Polonisë.

Gjithashtu është përmbyllur me sukses projekti i bashkëpunimit bilateral **"Bashkëpunimi për zhvillimin institucional të ZKA-së 2017 -2020"** me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë (SNAO). Ndërsa, me 18 dhjetor 2020, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, dhe Auditorja e Përgjithshme e Suedisë, Helena Lindberg, në një takim virtual, kanë nënshkruar marrëveshjen e re të bashkëpunimit bilateral "Bashkëpunimi për zhvillimin institucional të ZKA-së 2020 – 2023" në mes të ZKA-së dhe SNAO-s. Memorandumi i bashkëpunimit ka për qëllim zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve organizative të ZKA-së që promovojnë punë me cilësi të lartë, si dhe forcimin e kapacitetit për të përgatitur raporte të auditimit të performancës me cilësi të lartë dhe të dobishme për shoqërinë.

Gjatë vitit 2020, në shenjë respekti dhe bashkëpunimi të pandërprerë dhe frytshëm mes Institucioneve Supreme të Auditimit janë shënuar dy momente:

- Në një ceremoni festive, me 17 shkurt 2020, në kudër të shënimit të Ditës së Pavarësisë së Kosovës dhe në shenjë respekti për bashkëpunimin e pandërprerë e të frytshëm përgjatë viteve 2012-2019, në mes të Kontrollit të Lartë Shtetëror të Shqipërisë (KLSH) dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës (ZKA), Presidenti, Bujar Leskaj, në prani të zyrtarëve të lartë nga të dyja institucionet, ka përruruar Sallën e Bibliotekës së KLSH-së me emrin "Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës".
- Në shenjë falenderimi dhe respekti për ndihmën e gjithanshme e shumëvjeçare për ngritjen e kapaciteteve të personelit të Zyres Kombëtare të Auditimit (ZKA), gjatë vitit 2020 në ambientet e ZKA-së u bë inaugurimi i sallës së trajnimeve me emrin e institucionit të Zyres Kombëtare të Auditimit të Suedisë (SNAO). Inagurimi i kësaj ngjarje u bë nga Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, dhe Auditorja e Përgjithshme e Suedisë, Helena Lindberg.

Fotogaleria 5. Takime bilaterale dhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare



1. Nënshkrimi i marrëveshjes mes ZKA-së dhe SNAO-s
2. Takim bilateral, AP i Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Kosovës
3. Inagurimi i sallës SNAO
- 4 dhe 5. Konferenca e mbajtur në Podgoricë

Gjatë muajit shkurt, Auditori i Përgjithshëm Besnik Osmani dhe kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Transfere, Hekuran Murati morën pjesë në konferencën regjionale "Puna me Parlamentin për të përmirësuar ndikimin e auditimit" e organizuar nga OECD/SIGMA, ku nikoqir ishte Institucioni Shtetëror i Auditimit të Malit të Zi. Kjo konferencë është mbajtur në kuadër të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve candidate dhe candidate të mundshme për Bashkimin Evropian (BE) dhe Gjykatës Evropiane të Auditorëve.

Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, po ashtu mori pjesë në Konferencën Vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit "Analiza Vjetore e KLSH-së për vitin 2019" të mbajtur me 28 shkurt 2020.

Gjatë vitit, 2020 janë mbajtur shumë uebinare, diskutime online, janë krijuar blogje dhe uebfaqe të veçanta elektronike, në të cilat ZKA-ja ka marrë pjesë aktive dhe ka dhënë kontributin e vet në aktivitetet si:

- Seminari regjional "Sigurimi i cilësisë dhe kontrollit në auditim" i organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë dhe me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve nga ISA-t e Malit të Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinës;
- Serinë e webinarëve "Auditimi kompleks dhe sfidues" i organizuar nga Komiteti për Ndërtimin e Kapaciteteve të INTOSAI-t;
- Uebinarin "Bashkëpunimi i ISA-ve me organizatat e shoqërisë civile dhe angazhimi i qytetarëve" organizuar nga Institucioni Suprem i Auditimit të Afrikës së Jugut në partnership me INTOSAI Donor Cooperation;
- Uebinari "Pavarësia e ISA-ve" organizuar nga INTOSAI Donor Cooperation;
- Uebinari "Auditimi i fondeve të donatorëve nga ISA-" organizuar nga Komiteti i INTOSAI-t për Zhvillimin e Kapaciteteve;
- Seminari "Përfitimet e kontrollit të njëkohshëm dhe Zbatimi i Teknologjisë", organizuar nga ISA e Perusë;
- Uebinari "Perspektiva bihevoriste për përmirësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit në komunat e Kosovës" organizuar nga OSBE-ja dhe Idea42;
- Seria e seminareve regjionale "Forcimi i mbikëqyrjes së shërbimeve të sektorit të itelegjencës në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut" organizuar nga Qendra Evropiane për Studime të Sigurisë (CESS)
- Uebinari "Shfrytëzimi i llogaridhënies përmes auditimit të jashtëm publik" organizuar nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t;
- Seria e webinarëve "ISA-t inovative" organizuar nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t;
- Seria e takimeve online "Çështje të auditimit lidhur me Covid – 19" organizuar nga SIGMA në kuadër të Rrjetit dhe
- Uebinari "Kapaciteti, performanca dhe relevanca e ISA-ve gjatë dhe pas Covid-19", organizuar nga Komiteti i INTOSAI për Zhvillimin e Kapaciteteve.

Gjithashtu, ZKA-ja në vazhdimësi ka ofruar të dhëna dhe ka azhurnuar ato sipas kërkesës, në kuadër të shkëmbimit të njohurive dhe informatave në çështjet lidhur me menaxhimin e pandemisë, auditimit të Covid-19 si dhe të tjera kryesisht lidhur me paketat e rregullore dhe udhëzuesve të auditimit, të organizuara nga Rrjeti, Komiteti i Kontaktit të ISA-ve, Analizës Globale për ISA-t të, INTOSAI-t, si dhe kërkesave individuale nga ISA-t partnere.

ZKA-ja ka kryer me kohë dhe relevancë të gjitha raportimet lidhur me Planin Kombëtar për zbatimin e MSA-së dhe Strategjisë për Reformën në Menaxhimin e Financave Publike, si dhe të gjitha obligimet tjera që lidhen me integrimin evropian.



2 FOKUSI I AKTIVITETEVE GJATË VITIT 2021

2. FOKUSI I AKTIVITETEVE GJATË VITIT 2021

Viti 2021 është viti i fundit i Planit strategjik aktual (2018-2021). Krahas angazhimit për realizimin e aktiviteteve të mbetura në kuadër të këtij plani (disa prej të cilave janë vijimësi e atyre që kanë filluar së realizuari gjatë vitit 2020), këtë vit do të bëhet edhe vlerësimi dhe diagnostikimi i gjendjes ekzistuese që do t'i paraprij hartimit të planit të ri strategjik.

Gjatë vitit 2021 fokusi do të jetë në aktivitetet në vijim:

Qëllimi 1: Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të ZKA-së, në përputhje me SNISA-të

- Inicimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore, në përputhje me SNISA-të, që do të mundësonte aplikimin e metodologjisë për përzgjedhjen e auditimeve bazuar në rrezik
- Finalizimi i përditësimit të metodologjisë së auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë
- Finalizimi i zhvillimit të softuerit për menaxhimin e auditimit (SITA)

Qëllimi 2: Zhvillimi dhe forcimi i kapacitetit institucional për të mbështetur auditimin dhe qeverisjen korporative

- Ngritja dhe forcimi i mëtejme i kapaciteteve profesionale të personelit për zbatimin e objektivave strategjike
- Forcimi i mëtejme i kontrolleve të brendshme institucionale

Qëllimi 3: Komunikimi, integrimi, ndikimi

- Hartimi dhe fillimi i zbatimit të Planit për implementimin e Strategjisë për Komunikim me palët e jashtme dhe publikun, shoqërinë civile dhe mediat
- Intensifikimi i komunikimit me komisionet parlamentare
- Përcjellja e progresit në zbatimin e rekomandimeve dhe publikimi i bazës së të dhënave për rekomandimet e pazbatuara
- Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e organizatave profesionale të auditimit INTOSAI dhe EUROSAL.

3

**LLOGARIDHËNIA
E ZKA-SË**

3. LLOGARIDHËNIA E ZKA-SË

Pasqyrat Vjetore Financiare të ZKA-së janë dorëzuar dhe janë përfshirë në raportin e Qeverisë për Buxhetin e Kosovës për vitin 2020 në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Kurse në këtë Raport janë përfshirë Pasqyrat Vjetore Financiare të audituara si dhe opinioni i dhënë nga auditorët e jashtëm të pavarur.

ZKA-ja në kuptim të raportimit financiare, është llogaridhënëse sipas nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Besnik Osmani,
Auditor i Përgjithshëm

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: PORTOFOLI I AUDITIMEVE PËR SEZONIN 2019/20 DHE 2020/21

Në sezonin e auditimit 2019/2020 janë publikuar **127 raporte** të auditimit, si në vijim:

119 raporte të auditimit të rregullsisë (financiare me pajtueshmëri), për:

- Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës, të vitit 2019
- 57 Institucione të Nivelit Qendror
- 38 Komuna
- 14 Ndërmarrje Publike:
 - Telekom i Kosovës sh.a
 - Posta e Kosovës sh.a
 - Trainkos sh.a
 - KUR Prishtina sh.a
 - KUR Hidroregjioni Jugor sh.a
 - KUR Drini i Bardhë sh.a
 - KUR Hidromorava (për herë të parë)
 - KUR Bifurkacioni (për herë të parë)
 - Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a
 - KRM Uniteti sh.a
 - KRM Pastrimi sh.a,
 - Stacioni i Autobusëve sh.a – Prishtinë
 - Hortikultura sh.a Prishtinë
 - Ndërmarrje e re Energjetike (për herë të parë).

9 projekte të financuara nga donatorët:

- Zhvillimi rural dhe agrobujqësor (MBPZHR)
- Ekonomia Digjitale në Kosovë-
- Forcimi i Planifikimit dhe Ekzekutimit në Para të Gatshme-
- Projekti për përmirësimin e sistemit edukativ të Kosovës (MASHT)
- Projekti për Shëndetësinë e Kosovës (MSH)
- Eficienca e energjisë së ripërtëritshme (MZHE)
- Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksportim (MTI)
- Programi Mjedisor i Kosovës, PMK 2016-2020 (MMPH-SIDA), dhe
- Përkrahja për përmirësimin e hartimit (zhvillimit) të politikave në Kosovë (ZKM-SIDA)

8 auditime të performancës

- Procesi i licencimit të shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore e industriale dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari
- Efektiviteti i ndërlidhjes së arsimit dhe aftësimin profesional me nevojat e tregut të punës
- Organizimi dhe menaxhimi i investimeve të teknologjisë së informacionit në institucionet publike
- Menaxhimi i Obligimeve Tatimore në Sistemet e Informacionit të Administratës Tatimore të Kosovës
- Qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve në ASK
- Zbatimi i rekomandimeve të raportit "Administrimi i programit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike dhe vlerësimi i rezultateve
- Zbatimi i rekomandimeve të raportit "Fondi Zhvillimor" dhe efektet e fondit"
- Raporti i vlerësimit të zbatimit të rekomandimeve për auditimet e performancës të vitit 2017"

Ndërsa, për sezonin e auditimit 2020/21, i cili ka filluar në shtator të vitit 2020, ZKA-ja planifikon të përfundojë 124 raporte të auditimit, si në vijim:

116 raporte të auditimit të rregullsisë, për:

- Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës të vitit 2020
- 52 Institucione të Nivelit Qendror
- 38 Komuna
- 12 Ndërmarrje publike:
 - Telekom i Kosovës sh.a
 - Posta e Kosovës sh.a
 - Trainkos sh.a
 - KUR Prishtina sh.a
 - KUR Hidroregjioni Jugor sh.a
 - KUR Drini i Bardhë sh.a
 - KUR Hidromorava sh.a
 - KUR Bifurkacioni sh.a
 - Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës
 - Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a
 - KRM Pastrimi sh.a,
 - Hortikultura sh.a Prishtinë

13 projekte të financuara nga donatorët:

- Zhvillimi rural dhe agrobujqësor (MBPZHR-BB)
- Ekonomia Digjitale në Kosovë (MEA-BB)
- Projekti për Përmirësimin e Sistemit Edukativ të Kosovës (MASHT-BB)
- Projekti për Shëndetësinë e Kosovës (MSH-BB)
- Efiçenca e energjisë së ripërtëritshme (MZHE-BB)
- Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksportim (MTI-BB)
- Programi Mjedisor i Kosovës, PMK 2016-2020 (MMPH-SIDA)
- Përkrahja për përmirësimin e hartimit (zhvillimit) të politikave në Kosovë (ZKM-SIDA)
- Projekti i emergjencës COVID-19 në Kosovë (MSH-BB)
- Financimi i emergjencës pandemike në Kosovë (MSH-BB)
- Projekti i emergjencës COVID-19 në Kosovë (MPMS-BB)
- Pasuria e paluajtshme dhe infrastruktura gjeohapësinore (Agjencia Kadastrale e Kosovës) dhe Projekti "Komunat për rininë në Kosovë" (MAPL-BB)

8 auditime të performancës (për fusha të ndryshme, TI, prokurim, projekte)

- SMIL-Sistemi për Menaxhimin Informativ të lëndëve në Gjykata dhe Prokurori
- Sistemet Elektronike për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve në ABZH-MBPZHR
- Auditimi i fondeve të DEMOS- grantet e performancës komunale
- Vlera për para për ndërtimin e rrugëve lokale
- Menaxhimi i pandemisë Covid -19
- Ndikimi i subvencioneve të OJQ-ve në arritjen e qëllimeve të synuara
- Menaxhimi i mbeturinave komerciale dhe
- Menaxhimi i situatave emergjente.

SHTOJCA 2: PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZKA-SË PËR VITIN 2020

Pasqyrat financiare dhe raporti i pavarur i auditorit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	
Neni 12. Deklarata për prezentimin e pasqyrave financiare	1
Neni 13. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme	2
Neni 14. Raporti i ekzekutimit të buxhetit	3
Neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit	4-5
Neni 15. Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare	6 – 21
Neni 25. Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave	22
Neni 26. Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave	22
Neni 27 Raport për numrin e të punësuarve me kontratë për shërbime të veçanta	23
Neni 28 Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet për Zyrën Kombëtare të Auditimit për vitin paraprak	23 - 24
Shtojcë: Shpenzimet e ndërlidhura me menaxhimin e pandemisë COVID-19	25

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Auditorin e Përgjithshëm

Opinionit ynë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "Organizata" ose "ZKA"), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme dhe Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020 dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, performancën financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar në bazë të Bazës së Parasë së Gatshme të Kontabilitetit.

Bazat për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve dhe kërkesave janë përshkruar më tej në seksionin e raportit tonë për përgjegjësitë e auditorit për auditimin e të pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur për organizatën në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve/ Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionalistë (kodi IESBA) së bashku me kërkesat etike të / L-032 Ligjit Nr 6 (për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim), të cilat janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për të vazhduar në vijimësi, shpалosjen, sipas rastit, çështjet që lidhen me vazhdimin në vijimësi dhe duke përdorur bazën kontabilitetit për vazhdimin në vijimësi, përveç nëse Menaxhmenti ose synon të likuidojë organizatën ose të pushojë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste, porpos për ta bërë këtë. Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, dhe të lëshojmë raportin e auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel të lartë të sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një pasaktësi materiale kur ajo ekziston. Pasaktësitë mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e pasaktësiave materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një pasaktësie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se për një pasaktësi që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjen e fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje e kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrolleve të brendshme relevante për auditimin me qëllim hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të lidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga Menaxhmenti të bazës së kontabilitetit për të vazhduar në vijimësi dhe në bazë të dëshmive të marra të auditimit, dhe nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar për të tërhequr vëmendjen në raportin e auditorit tonë ndaj shpalosjeve të lidhura në pasqyrat financiare ose, nëse shpalojset e tilla janë të pamjaftueshme, për të modifikuar opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në prova të auditimit të marra të deri në datën e Raportit të Auditorit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të ndërpres së qeni sipas bazës së vazhdimit në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet themelore dhe ngjarjet në një mënyrë që arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me të ngarkuarit me qeverisje në lidhje me, mes çështjeve të tjera, shtrirjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Në gjithashtu sigurojmë të ngarkuarit me qeverisje me një deklaratë që jemi në pajtueshmëri me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe për të komunikuar me ta të gjitha marrëdhëniet dhe çështje të tjera që me arsye mund të mendohet të bien në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masa mbrojtëse të lidhura.

Nga çështjet e komunikuar me të ngarkuarit me qeverisje, kemi përcaktuar ato çështje që janë të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Ne përshkruajmë këto çështje në raportin e auditorit përveç kur ligji apo rregullorja e pengon zbulimin publik në lidhje me këtë çështje, ose kur, në rrethana shumë të rralla, përcaktojmë që një çështje nuk duhet të komunikohet në raportin tonë, sepse pasojat negative e të bërit këtë në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të peshoj më shumë përfitimet e interesit publik nga komunikimi i tillë.

Raport tjetër mbi kërkesat rregullatore të autoritetit mbikqyrës, Kuvendi të Republikës së Kosovës për përputhshmërinë ligjore të ZKA.

Në bazë të kërkesave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ne kemi rishikuar aspektin e përputhshmërisë ligjore të ZKA-së. Nga rishikimi i kryer nuk kemi identifikuar ndonjë mospërputhje me ligjet që rregullojnë funksionimin e ZKA.

Avni Musliu

Avni Musliu, Auditor Ligjor

Nexia KS 8/2020

Nexia KS Sh.P.K.



Rr: Str Xhevdet Doda,
Hyrja B, Kati 14, B1, Prishtinë, Kosovë

6 prill 2020

Neni 12

DEKLARATË PËR PREZANTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: z. AHMET ISMAILI, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit
Nga: z. IMRI SEMETISHTI, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)
z. ADEM SYLEJMANI, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e pasqyrave financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020 dhe është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne konfirmojmë, për sa kemi njohuri dhe besim, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësinë apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimit të tyre të lidhura me Buxhetin e Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2020.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpалosur në mënyrë të duhur.
- Të gjitha huatë janë regjistruar dhe/ose janë shpалosur, sipas legjislacionit në fuqi.
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpалosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Datë: 22/02/2021


Nenshkrimi i ZKA

Datë: 22/02/2021


Nenshkrimi i ZKF

Zyra Kombëtare e Auditimit

Neni 13. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmenden ndryshe)

	2020	2019	2018
	Llogaria e vetme e Thesarit BKK € '000	Llogaria e vetme e Thesarit BKK € '000	Llogaria e vetme e Thesarit BKK € '000
	Shënime		
BURIMET E FONDEVE – PRANIMET			
Granti qeveritar	3,026	2,753	2,696
Të hyrat vetanake	15	20	-
Të hyrat nga AKP	-	122	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve Tjera/Donacion	-	95	19
Gjithsej	3,041	2,990	2,718
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT			
Operacionet			
Pagat dhe mëdijet	2,216	2,125	2,003
Mallrat dhe shërbimet	523	710	631
Shërbimet komunale	30	33	30
	2,769	2,868	2,664
Shpenzimet kapitale Tjera/Donacion	272	122	51
Gjithsej	3,041	2,990	2,718

Zyra Kombëtare e Auditimit

Neni 14. Raporti i ekzekutimi te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore aktuale për Zyrën Kombëtare të Auditimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Shënime	2020			2019		2018	
	Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Variance	Realizimi	Realizimi	
	A € '000	B € '000	C € '000	D=B-A € '000	E € '000	E € '000	
Hyrja e parashë gatshme	-	-	-	-	114	-	
Grantet e përcaktuara të donatorëve	6	-	-	-	-	-	
Të hyrat tjera	7	20	20	(0)	28	3	
Gjithsej pranimet	20	20	20	(0)	142	3	
Daljet e parashë gatshme	-	-	-	-	-	-	
Pagat dhe mëdijet	2,216	2,216	2,078	0	2,125	2,003	
Mallrat dhe shërbimet	523	564	692	(41)	710	631	
Shërbimet komunale	30	32	45	(2)	33	30	
Shpenzimet kapitale	272	272	300	-	122	51	
Tjerrat/Donacione	-	-	-	-	-	3	
Gjithsej pagesat	3,041	3,084	3,115	(43)	2,990	2,718	

Zyra Kombëtare e Auditimit

Neni 14. Raporti i ekzekutimi të buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore aktuale për Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin e përfunduar më 31

Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Kategoria e ndarjes	Buxheti		Ndryshimet e autorizuara nga LMFPP						Ndryshim et e buxhetit fillestar € '000
	Shënim	Sipas Ligjit i buxheti t)	Ndryshimi sipas nenet 29,Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi sipas nenet 30,Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi për te hyrat e tjera të financimit	Ndryshimi për grantet e përcaktuara te donatorëve	Hyrat Vetana ke	Të Burime tjera të financimit € '000	
	a	b	c	d	e	f	g	i=(a+b+c+d+e+f +g+h)	k=(i-a)/i
Hyrjet									
Grantet e përcaktuara te donatoreve	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Te hyra te tjera	14.6.1	20	-	-	-	-	-	20	0%
		20	-	-	-	-	-	20	0%
Daljet									
Pagat dhe medijet	14.6.2	2,078	-	138	-	-	-	2,216	6%
Mallrat dhe shërbimet	14.6.3	692	(100)	(28)	-	-	-	564	(23%)
Shërbimet komunale	14.6.4	45	(16)	3	-	-	-	32	(42%)
Shpenzimet kapitale	14.6.5	300	(150)	122	-	-	-	272	(10%)
Totali		3,115	(266)	235	-	-	-	3,084	(100)

Shënime:

14.6.1 Ligji Nr. 07/1-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 07/L-014, për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 20,000€ në emër të të hyrave vetanake.

14.6.2 Me Ligjin Nr. 07/1-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 07/L-014, për kategorinë e Pagave dhe Medijeve është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 2,077,454€. Ndërsa, Qeveria e Kosovës përmes Vendimit me Nr. 09/50 të datës 21.12.2020 për kursime dhe ndarje dhe rregullime në kategoritë e shpenzimeve të organizatave buxhetore për vitin 2020, ZKA-së në kategorinë e pagave dhe medijeve iu është ndarë shuma prej 138,364.39€. Buxheti final për kategorinë ekonomike "paga dhe medijet" në fund të vitit ishte 2,215,818€.

Zyra Kombëtare e Auditimit

Neni 14. Raporti i ekzekutimi te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore aktuale për Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmenden ndryshe)

14.6.3 Me Ligjin Nr. 07/1-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 691,695€ që përfshin edhe të hyrat vetanake. Ndërsa, Qeveria e Kosovës përmes rishikimit buxhetor me Ligjin Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020, ZKA-së nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve i është reduktuar shuma prej 100,000€. si dhe Vendimin Nr. 09/50 të datës 21.12.2020 për kurseme dhe ndarje dhe rregullime në kategoria të shpenzimeve të organizatave buxhetore për vitin 2020, ZKA-së nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve iu është reduktuar shuma prej 14,320.65€. Poashtu, ZKA përmes Vendimit Nr. 400/2671 të datës 22.09.2020 ka bërë kërkesë për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike "mallra dhe shërbime" në kategori tjera ekonomike në shumë të përgjithshme prej 13,423€. Buxheti final për kategorinë ekonomike "mallra dhe shërbime" në fund të vitit ishte 563,951€.

14.6.4 Me Ligjin Nr. 07/1-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, për kategorinë e Shërbimeve komunale është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 45,000€. Ndërsa, Qeveria e Kosovës përmes rishikimit buxhetor me Ligjin Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020 ZKA-së nga kategoria e Shpenzimeve Komunale iu është reduktuar shuma prej 16,420€. Me qëllim të mbulimit të shpenzimeve nga reduktimi i mjeteve si rrjedhojë e rishikimit buxhetor nga Qeveria, ZKA përmes Vendimit Nr. 400/2671 të datës 22.09.2020 ka bërë kërkesë për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike "mallra dhe shërbime" në "shpenzime komunale" në shumë prej 3,000€. Buxheti final për kategorinë ekonomike "shpenzime komunale" në fund të vitit ishte 31,580€.

14.6.5 Me Ligjin Nr. 07/1-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, për kategorinë e Shpenzimeve kapitale është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 300,000€. Ndërsa, Qeveria e Kosovës përmes rishikimit buxhetor me Ligjin Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020/ZKA-së nga kategoria e Investimeve kapitale iu është reduktuar shuma prej 150,000€. Me datën 14.09.2020, Qeveria e Kosovës përmes Vendimit me Nr. 06/30 të datës 14.09.2020 me qëllim të zbatimit të projektit "softuer për menaxhimin e proceseve të auditimit" ka ndarë mjete financiare në shumë prej 111,801€. Me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të kontraktuara të dy projekteve kapitale, dhe si rrjedhojë e reduktimit të mjeteve nga rishikimi buxhetor nga ana e Qeverisë, ZKA përmes Vendimit Nr. 400/2671 të datës 22.09.2020 ka bërë kërkesë për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike "mallra dhe shërbime" në "investime kapitale" në shumë prej 10,423€. Buxheti final për kategorinë ekonomike "Investime Kapitale" në fund të vitit ishte 272,224€.

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Shënimi 1 Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007.

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Entiteti i sektorit publik, Zyra Kombëtare e Auditimit ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007.

Sipas LMFPP të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka përcaktuar Auditorin e Përgjithshëm si institucion i pavarur dhe më i lartë, i kontrollit ekonomik e financiar në vend. Kompetencat themelore të Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar me Kushtetutë dhe janë definuar më tej me ligjin e veçantë Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2016. Sipas legjislacionit në fuqi, Auditori i Përgjithshëm ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij. Ai është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së. ZKA është institucion i pavarur kushtetues me mandat për kryerjen e auditimit të jashtëm në të gjitha organizatat buxhetore dhe në subjektet tjera shtetërore.

Vizioni i ZKA-së

Institucion i besueshëm i auditimit, që përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve.

Misioni i ZKA-së

Përmes auditimeve cilësore të fuqizojë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Vlerat e ZKA-së

- Pavarësia;
- Profesionalizmi;
- Integriteti; dhe
- Transparenca.

1.2 Pagesat nga palët e treta

Në zbatim të SNKSP 2017 pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 8.

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

1.3 Shumat raportuese

Shumat raportuese janë të prezentuara si vijon:

- 13 deri të nëni 15 janë në '000 (mijë) Euro (€),
- 16 deri të nëni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

1.4 Valuta raportuese

Librat dhe shënimet e ZKA-së mbahen në Euro, që është valuta ligjore në territorin e Republikës së Kosovës.

1.5 Data e autorizimit

Autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës për Pasqyrat Financiare nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

1.6 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare përfshijnë shpalosjet të kërkuara nëpërmjet Rregullores Financiare Nr. 01_2017 Për Raportimin Vjetor Financiar të Organizatave Buxhetore.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me bazën e pranimit dhe pagesave në para të gatshme. Nën këtë bazë:

- Të hyrat njihen kur pranohen. Ato alokohen nga fondet e disponueshme në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës ("BKK"), të cilat janë për tu shpenzuar në lidhje me këtë ndarje dhe të njohur si "fonde të alokuara" për këtë ndarje.
- Shpenzimet njihen kur paguhet nga llogaria e BKK-së.
- Aktivet jo-monetare paraqiten për qëllime të shpalosjes. Kostoja historike për asetet e tilla përfaqëson kostot e blerjes dhe çdo shpenzim shtesë drejtpërdrejtë i atribuohet blerjes së aseteve.

1.7 Prokurimi

Marrëveshjet kontraktuese për blerje të mallrave ose shërbimeve, duke përfshirë shërbimet profesionale, nënshkruhen në emër të ZKA-së, vetëm nga zyrtarët e autorizuar. Aktivitetet për blerje përveç nënshkrimit të kontratës, përfshijnë ftesën për tenderë, kuotime mbi bazën e specifikimeve të detajuara siç përcaktohet në Ligji mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

1.8 Zotimet

Zotimet, ashtu siç janë shpalosur në pasqyrat financiare, regjistrohen kur urdhërohet ndonjë blerje që ka të bëjë me vitin aktual buxhetor.

1.9 Buxheti

Buxheti final është i përfshirë në Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar të Kosovës dhe gjithashtu është publikuar si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare (vazhdim)

Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale

Për dallim prej shënimeve 2 deri 12, këto shënime përdoren për të sqaruar dallimin **material** në kolonën **D** (neni 14), domethënë dallimin material të realizimit të buxhetit. SNKSP në bazë të parasë së gatshme kërkon të sqarohen dallimet materiale. Varësisht nga madhësia e dallimit, nuk kanë nevojë të ofrohen shpjegime për të gjitha kategoritë, andaj mund të kërkohen ndryshime në sistemin e numërimit të shënimeve. Kur të sqarohen dallimet e ndonjë kategorie të ndarjes, duhet të jepet përmbledhja e natyrës së ndryshimit.

Shënimi 2 Paga dhe rroga

		2020				2019	2018
		Gjithsej pagesat	GQ	Buxheti final	Krahasim %	GQ	GQ
Përshkrimi	Shënim	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Pagat neto përmes listës së pagave		1,844	1,844	1,844	100	1,769	1,668
Tatimi mbi të hyrat personale		156	156	156	100	149	140
Kontributi pensional nga punëdhënësi		105	105	105	100	101	95
Kontributi pensional nga i punësuar		105	105	105	100	101	95
Pagesa për Sindikatë		6	6	6	100	5	5
Paga dhe rroga		2,216	2,216	2,216	100	2,125	2,003

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare (vazhdim)

Shënimi 3 Mallrat dhe shërbimet

Përshkrimi	Shënim	2020				2019		2018	
		Gjithsej pagesat € '000	GQ € '000	THV € '000	Buxheti final € '000	Krahasim %	GQ € '000	GQ € '000	
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	3.1	1	1	-	2	66%	9	6	
Mëdija e udhëtimit brenda vendit	3.1	8	8	-	8	98%	13	7	
Akomodimi për udhëtimet brenda vendit	3.1	15	15	-	15	100%	27	20	
Shpenzimet tjera për udhëtimet brenda vendit	3.2	0	0	-	1	26%	0	-	
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	3.2	-	-	-	1	0%	26	16	
Mëdija e udhëtimit jashtë vendit	3.2	1	1	-	1	90%	33	41	
Akomodimi për udhëtimet jashtë vendit	3.2	0	0	-	1	90%	30	22	
Shpenzimet tjera të udhëtimit jashtë vendit	3.2	0	0	-	0	39%	5	5	
Internet		8	8	-	8	97%	7	7	
Shpenzimet e telefonisë mobile	3.3	26	26	-	27	97%	28	27	
Shpenzimet postare		1	1	-	1	66%	0	2	
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	3.4	7	-	7	8	89%	44	3	
Shërbimet e ndryshme intelektuale këshillëdhënëse	3.5	32	32	-	34	95%	85	28	
Shërbime shtypje - jo marketing	3.6	-	-	-	0	0%	4	9	
Shërbime kontraktuale tjera	3.7	48	48	-	50	96%	38	26	
Shërbime teknike		0	0	-	1	12%	1	1	
Shpenzimet për anëtarësim		1	1	-	1	51%	-	-	
Mobiljet dhe pajisjet (më pak se 1000)	3.8	8	4	4	10	83%	33	22	
Telefona (më pak se 1000€)		-	-	-	-	0%	-	1	
Komputerë (më pak se 1000€)	3.9	26	26	-	28	93%	2	22	
Hardware për TI < 1000	3.10	-	-	-	2	0%	15	5	
Pajisje trafiku		-	-	-	-	0%	-	1	
Pajisje tjera < 1000€	3.11	1	1	-	2	56%	3	24	

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Blejja e librave	-	-	-	-	1	0%	-	-
Furnizime për zyrë	26	3.12	22	3	30	85%	16	31
Furnizime ushqim dhe pije	21	3.13	21	-	22	94%	14	24
Akomodimi	1	-	1	-	1	99%	-	6
Naftë për ngrohje	20	-	20	-	21	93%	20	6
Derivate për gjenerator	1	-	1	-	1	84%	2	1
Karburant për vetura	6	3.14	6	-	7	84%	11	11
Regjistrimi i automjeteve	1	-	1	-	1	78%	1	1
Sigurimi i automjeteve	4	-	4	-	4	92%	4	3
Taksa komunale	0	-	0	-	0	73%	0	-
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera	18	3.15	18	-	22	83%	11	12
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	7	3.16	7	-	9	74%	8	7
Mirëmbajtja e ndërtesave	34	3.17	33	1	35	97%	23	27
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	19	-	19	-	22	86%	20	14
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	2	-	2	-	4	56%	2	2
Qiraja për ndërtesa	162	-	162	-	162	100%	162	147
Qiraja-pajisje	5	-	5	-	5	90%	4	10
Qiraja-makineria	5	3.18	5	-	5	98%	-	-
Qiraja-përdorime tjera të hapësirave	1	-	1	-	1	50%	1	1
Reklamata dhe konkurset	1	-	1	-	2	69%	2	16
Botimet e publikimeve	7	3.19	7	-	7	94%	-	-
Informimi publik	0	-	0	-	1	30%	-	0
Drekat zyrtare	0	-	0	-	1	95%	5	3
Dreka zyrtare jashtë vendit	0	-	0	-	0	14%	0	0
Tatimi në qira	-	-	-	-	-	0%	1	14
Mallra dhe shërbime	523		508	15	564	93%	710	631

Shënime:

3.1 Kjo shumë paraqet shpenzimet për ekipet audituese në terren në entitetet që janë larg selisë së ZKA. Shpenzimet janë më të ulta, për shkak të masave të ndërmarra për mbrojtjen e punonjësve nga pandemia COVID-19 dhe realizimit të punës në distancë (online).

Zyra Kombëtare e Auditimit Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare 31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

3.2 Kjo shumë prezanton shpenzimet e realizuara për qëllime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit të punonjësve të ZKA-së, të cilat gjatë vitit 2020 ishin ulur skajshmërisht si pasojë e pandemisë COVID-19.

3.3 Shpenzimet e telefonisë mobile janë më të ulëta si pasojë e pandemisë COVID-19, pasi që puna më e madhe është kryer nga distanca (online).

3.4 Shpenzimet për këtë kategori në veçanti përfshijnë shpenzimet e përkrabjes në aftësimin profesional të auditorëve. Gjatë këtij viti, shpenzimet janë më të ulëta, për shkak të përfundimit të projektit për "Fuqizimin e kapaciteteve të Zyrtës Kombëtare të Auditimit në projektet e auditimit të prokurimit" me Bankën Botërore, ku shumën e përkrabjes ishte më e madhe.

3.5 Në këtë kategori përfshihen shpenzimet e realizuara ndaj kompanive të auditimit të angazhuara në kryerjen e auditimeve në emër të ZKA-së në auditimin e kontraktuar. Gjatë këtij viti, shpenzimet janë më të ulëta, për shkak të përfundimit të projektit për "Fuqizimin e kapaciteteve të Zyrtës Kombëtare të Auditimit në projektet e auditimit të prokurimit" me Bankën Botërore, ku shumën e përkrabjes ishte më e madhe.

3.6 Shpenzimet e kësaj kategorie janë shpërndarë në një nën-kod tjetër, respektivisht tek Botimi i publikimeve, për atë arsye edhe nuk kemi shpenzime në këtë kategori.

3.7 Shpenzimet e kësaj kategorie përfshijnë, Kontratën për shërbime të përkthimit, pagesat për angazhimin e auditorëve të përkohshëm, kontraktuesit e tjerë, pagesat ndaj ATK-se dhe Trustin. Shpenzimet në këtë kategori janë rritur si rrjedhojë e situatës pandemike në vend dhe nevojës për të përmbyshur obligimet ligjore në kohë.

3.8 Në këtë kategori paraqiten shpenzimet për furnizim me mobilje për vitin 2020. Shpenzimet më të ulëta, janë për shkak se gjatë këtij viti nuk kemi pasur kërkesa të theksuara për ripërtirje të mobiljeve me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme për punonjësit e ZKA-së. Në këtë gjendje ka kontribuar edhe situata pandemike COVID-19, ku hapësirat e punës nuk janë shfrytëzuar gjatë gjithë kohës.

3.9 Në këtë kategori paraqiten shpenzimet për furnizim me Laptopë për vitin 2020. Gjatë këtij viti, shpenzimet janë më të larta, si rezultat i blerjes së 40 laptopëve për nevojën të punës së auditorëve në teren dhe krijimit të kushteve më të favorshme për punë në distancë (online).

3.10 Shpenzimet në këtë kategori janë më të ulëta për shkak të kursimeve të projektuara me qëllim të menaxhimit të situatës pandemike në vend të COVID-19.

Zyra Kombëtare e Auditimit Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare 31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmeridet ndryshe)

- 3.11 Kjo shumë prezanton shpenzimet për furnizim me pajisje tjera për nevoja të ZKA-së. Shpenzimet janë me te ulta, për shkak se shumica e nevojave janë përbushur në vitet paraprake si dhe përkujdesja më e shtuar në menaxhimin situatës pandemike në vend të COVID-19.
- 3.12 Kjo shumë prezanton shpenzimet për furnizim me material zyrtar për nevoja të zyrës. Kjo periudhë e vitit është karakterizuar me nevoja të veçanta, ku edhe shpenzimet janë më të larta për shkak se është dashur që të bëhen furnizime me pajisje mbrojtëse për COVID-19 (Maska dhe dorëza dhe material tjetër për të rritur sigurinë në punë).
- 3.13 Kjo kategori prezanton shpenzimet e byfësë, shpenzimet për furnizim me ujë të pijes, dhe organizimit të puntorive me rastin e publikimit të raporteve të auditimit. Shpenzimet për këtë kategori janë me të larta për faktin se ZKA është pranuar më të drejta të plota në organizatën profesionale të auditimit INTOSAI, dhe për këtë qëllim janë organizuar edhe një mori aktivitetesh për të shënuar këtë ngjarje.
- 3.14 Shpenzimet për këtë kategori, paraqesin shpenzimet e karburantit për vetura zyrtare të ZKA-së, të cilat në vitin 2020 janë më të ulta për shkak të krijimit të situatës pandemike në vend të COVID-19, dhe relativisht, puna jonë është organizuar në distancë (online).
- 3.15 Kjo kategori paraqet shpenzimet e sigurimit fizik të objektit dhe sigurimin e ndërtesës nga fatkeqësitë e mundshme natyrore. Shpenzimet më të larta për këtë kategori janë si rrjedhojë e kontratës së re për sigurim fizik të objektit dhe krijimit të kushteve më të mira për punonjësit e sigurimit.
- 3.16 Shpenzimet e paraqitura të kësaj kategorie paraqesin shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparime të veturave zyrtare të ZKA-së, të cilat janë më të ulta në krahasim me vitin paraprak, për faktin se veturat janë përdorur më pak pas krijimit të rrethanave të reja të ndikuar nga pandemia COVID-19.
- 3.17. Shpenzimet për këtë kategori përfshijnë mirëmbajtjen e ndërtesës së ZKA-së, krahasuar me vitin paraprak, shpenzimet për kategori janë më të larta për shkak të ndërhyrjeve në mirëmbajtjen e sistemit të ventilimit dhe ngrohjes qendrore, si dhe shpenzimeve të paparashikuara të ndikuara nga pandemia COVID-19.
- 3.18 Shpenzimet në këtë kategori përfshijnë marrjen me qira të një veture në fillim të vitit 2020, për qëllime zyrtare të punës në ZKA.
- 3.19 Shpenzimet më të larta në këtë vit krahasuar me vitin paraprak janë rezultat i rritjes së publikimeve/raporteve. Publikimet dhe shtypja e raporteve në vitin paraprak kanë qenë të shpalosura në një kod tjetër, të cilin nga ky vit është vendosur në këtë kod i cili është më adekuat.
- 3.20 Shpenzimet më të ulëta të kësaj kategorie janë si rrjedhojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmondet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare (vazhdim)

Përshkrimi	Shënim	2020			2019		2018	
		Gjithsej pagesat € '000	GQ € '000	GPD € '000	Buxheti final € '000	Krahësim %	GQ € '000	GQ € '000
Rryma	4.1	22	22		24		18	
Uji	4.2	1	1		1		2	
Mbeturinat		1	1		1		2	
PTK-fikse		6	6		6		8	
Shpenzimet komunale		30	30	-	32	96%	33	30

4.1 Në këtë kategori përfshihet shuma e shpenzimeve të rrymes për nevoja të ZKA-së. Shuma e shpenzuar është më e vogël për shkak të situatës pandemike në vend dhe mos-shfrytëzimit të pajisjeve që shpenzojnë rrymë si rrjedhojë e punës në distancë (online).

4.2 Në këtë kategori përfshihet shuma e shpenzimeve të ujit për nevoja të ZKA-së. Shuma e shpenzuar është më e vogël për shkak të situatës pandemike në vend dhe mos-shfrytëzimit të hapësirave në zyrë, si rrjedhojë e punës në distancë (online).

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Shënim i 5 Shpenzimet kapitale

Përshkrimi	2020			2019		2018	
	Gjithsej pagesat € '000	GQ € '000	TH- AKP € '000	Buxheti final € '000	Krahassim %	GQ € '000	GQ € '000
Server për përfundim të infrastrukturës së ZKA	-	-	-	-	0%	-	19
Vetura zyrtare	-	-	-	-	0%	34	32
Investim në vijim (Softwer për mbështetje të auditimit)	245	245	-	245	100%	50	-
Rifreskimi i infrastrukturës së TI	-	-	-	-	0%	18	-
Sistemi i përkthimit dhe zërimi	-	-	-	-	0%	13	-
Llogoja institucionale e ZKA-së	-	-	-	-	0%	7	-
Sistemi i pajisjeve kundër zjarrit	12	12	-	12	100%	-	-
Sistemi për nevoja të IT (kontrolli i rrjetit dhe licencat për back up	1.5	1.5	-	1.5	100%	-	-
Shpenzimet kapitale	272	272	-	272	100%	122	51

5.1 Kjo shumë paraqet shpenzimin e investimit në vijim të kontratës për zhvillimin e softuerit për Sistemin e Menaxhimit të Auditimit. Shuma e shpenzuar për vitin 2020 këtë kategori është 245,301€.

5.2 Kjo shumë paraqet shpenzimin për furnizim me pajisje të teknologjisë informative, për sistemin e pajisjeve kundër zjarrit në dhomen e servereve. Shuma e shpenzuar për këtë kategori është 11,942.78€.

5.3 Kjo shumë paraqet shpenzimin për furnizim me softuer kontrolli të rrjetit të teknologjisë informative si dhe licenca për back-up. Shuma e shpenzuar për këtë kategori është 14,974.2€.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare (vazhdim)

Shënimi 6: Grantet e përcaktuara të donatorëve

Emri i Donatorit	Nr. i projektit	Emri i projektit	2020 € '000	2019 € '000	2018 € '000
Banka Botërore	94138	Projekti për "Fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditim të prokurimit"	-	95	19
Total			-	95	19

Shënimi 7: Të hyrat vetanake jo tatimore

Gjatë vitit 2020, ZKA ka realizuar të hyra në vlerë të përgjithshme prej 19,810€, në emër të shitjes së shërbimeve të auditimit gjatë periudhës fiskale të vitit 2019.

Shërbimet e kryera janë për Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo (HSIK) për auditimin e performancës/pajtueshmërisë së projekteve kapitale të financuara përmes Granteve të Performancës, si dhe Një shumë prej 536.6€, nga gjenerimi i të hyrave të vitit 2019, e cila shumë është bartur për shfrytëzim në vitin 2020.

Përshkrimi	Shënime	2020	2019	2018	% e totalit 2020	% e ndryshimit nga 2019
		€ '000	€ '000	€ '000		
Të hyrat nga shitja e shërbimeve		20	28	3	100%	(26%)
Gjithsej		20	28	3	100%	(26%)

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare (vazhdim)

Shënimi 8: Pagesat nga palët e treta

Kategoria Ekonomike	Shënime	2020	2019	2018
		€ '000	€ '000	€ '000
Paga dhe rroga		-	-	-
Mallra dhe Shërbime		-	10	-
Shërbime Komunale		-	-	-
Shpenzime Kapitale		-	-	-
Gjithsej pagesat nga palët e treta		-	10	-

Neni 16 Raport për të arkëtueshmet

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2020	2019	2018
13460	Shërbime të auditimit	-	19,810	2,450
Gjithsej		-	19,810	2,450

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e paguara

Kodi ekon.	Kategoria ekonomike	2020		2019		2018	
		< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë
11	Paga dhe roga	-	-	-	-	-	-
13	Malira dhe shërbime	3,614	-	16,731	-	13,628	-
14	Shpenzime komunale Transfere dhe	2,893	-	597	-	2,415	-
20	subvencione	-	-	-	-	-	-
30	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-
Totali		6,507	-	17,328	-	16,044	-

Detajet e faturave

Data e pranimit të faturës	Numri i faturës	Afati i pagesës	Kodi ekonomik	Furnitori	Përshkrimi	Arsyja e mospagesës	Shuma
12/23/2020	88/20	30 ditë	14020	"Set Ashensori"	Mirëmbajtje e lifit	Janë zotuar më pak mjete se fatura (Janë paguar 436,07€ nga totali i 540€)	135,70
12/17/2020	046/2020	30 ditë	13610	"Zyra e Kryeministrit"	Gazeta zyrtare	Shërbimi është deri me 15.01.2021	10,00
12/29/2020	11/2020-ZKA	30 ditë	13330	"PTK"	Shpenzime postare	Fatura është pranuar pas skadimit të afatit për zotim	28,50
12/29/2020	2020-1228	30 ditë	14010	"Spinoza"	Larje e veturave	Fatura është pranuar pas skadimit të afatit për zotim	66,00
1/11/2021	21-SHV04-001-31	30 ditë	14140	"Mercor"	Qiraja për vetura	Fatura është pranuar në vitin 2021	497,96
1/11/2021	AH1183	30 ditë	14130	"Art House"	Qiraja për fotokopje	Fatura është pranuar në vitin 2021	167,33

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmondet ndryshe)

1/13/2021	4436-20	30 ditë	14020	"MSS"	Mirëmbajtje e ndërtesës	Fatura është pranuar në vitin 2021	1,465.02
12/15/2020	11/12/2020	30 ditë	13130	Florim Maliqi	Kompenzim për shpenzime të natës	Fatura është pranuar pas skadimit të afatit për zotim	18.99
12/11/2020	14-12-2020	30 ditë	13130	Valimira Jonuzi	Kompenzim për shpenzime të naftës	Kërkesa është pranuar pas skadimit të afatit për zotim	35.41
12/14/2020	55-210-001-20	30 ditë	13130	"Victory"	Shërbime të taxit	Kërkesa është pranuar pas skadimit të afatit për zotim	108.95
1/15/2021	5193/20	30 ditë	13780	"Petrol Company"	Naftë për vetura	Fatura është pranuar në vitin 2021	662.20
12/30/2020	Vendimi i ZKA, 21/6/2019	30 ditë	13440	Agon Hysaj	Komiteti i Auditimit	Kërkesa është pranuar pas skadimit të afatit për zotim	200.00
12/30/2020	Vendimi i ZKA, 21/6/2019	30 ditë	13440	Albulena Sadiku	Komiteti i Auditimit	Kërkesa është pranuar pas skadimit të afatit për zotim	200.00
1/22/2021	12/1/2020	30 ditë	13330	"PTK"	Shërbime postare	Fatura është pranuar në vitin 2021	18.30
Totali-Mallirat dhe shërbimet							3,614.36
12/14/2020	5500018412065	30 ditë	13250	"VALA"	Telefonia fikse	Janë zotuar me pak mjete se fatura (jane paguar 436.07€ nga totali i 540€)	103.93
1/1/2021	28090909	30 ditë	13210	"KEDS"	Rryma	Fatura është pranuar në vitin 2021	2,693.80
1/22/2021	1513816	30 ditë	13230	"Pastrimi"	Mbeturinat	Fatura është pranuar në vitin 2021	94.68
Totali-Shërbimet komunale							2,892.41

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 18 Detyrimet kontigjente		Vlera e vlerësuar ose e saktë		
Natyra e detyrimeve kontigjente	Arsyeja për detyrime	2020 € '000	2019 € '000	2018 € '000
Qiraja		-	-	11,000
Përbushje e kontratës	18.1	8,037	7,442	6,765
Page	18.2	27,942	25,872	18,480
Totali		35,979	33,314	36,245

Shënim:

18.1 Shuma e prezantuar paraqet vlerën e kontratës së nënshkruar për furnizim me material te zyros, si dhe vlerën potencialisht të rritur.

18.2 Shuma e prezantuar është një përlogaritje e kompensimit eventual për pagë për disa raste të kontesteve gjyqësore.

Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare

19.3.1) Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000€)

Klasifikimi i pasurive	Shënim	Vlera neto - 2020 € '000	Vlera neto - 2019 € '000	Vlera neto - 2018 € '000
Veturat	19.3.1.1	46,545	59,503	36,652
Pajisje të TI-së	19.3.1.2	16,679	33,965	31,928
Softuer		2,171	4,342	6,513
Pasuritë e tjera	19.3.1.3	27,396	18,619	596
Pasuritë fikse të paprekshme		20,651	7,493	9,058
Telefonia fikse		5,679	7,301	8,924
Investim në vijim - Softuer për auditim	19.3.1.4	294,837	49,537	-
Totali		413,958	180,760	93,671

Shënim:

19.3.1.1 Gjatë vitit 2020, sistemi automatik për shuarje të zjarrit është blerë dhe montuar në dhomën e serverave në vlerë prej 11,943 €.

19.3.1.2 Gjatë vitit 2020 në vlerën prej 14,974€ janë blerë pasuri fikse të paprekshme (PFP) për kontrollim të rrjetit si dhe PFP për backup.

19.3.1.3 Gjatë vitit 2020, shuma prej 245,300 € paraqet shumën e cila është paguar OE "INFOSOFT SYSTEMS" për zhvillimin e softuerit për menaxhimin e proceseve të auditimit, bazuar në kushtet e kontratës së nënshkruar në mes të ZKA-se dhe OE "INFOSOFT SYSTEMS".

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1000€)

	Shënim	Vlera historike 2020 € '000	Vlera historike 2019 € '000	Vlera historike 2018 € '000
Klasifikimi i pasurive				
Pajisjet dhe mobiljet	19.3.2.1	110,322	127,145	127,066
Totali		110,322	127,145	127,066

Shënim:19.3.2.1

Blerjet e reja gjatë vitit 2020 arrijnë vlerën 35,509 €.

Shuma prej 52,128 € prezanton vlerën e amortizimit të pasurive gjatë 2020

19.3.3 Stoqet

	Shënim	Vlera historike 2020 € '000	Vlera historike 2019 € '000	Vlera historike 2018 € '000
Klasifikimi i pasurive				
Material shpenzues		19,841	15,024	14,390
Derivate për ngrohjen qendrore dhe gjenerator	19.3.3.1	2,166	5,363	1,904
Totali		22,007	20,387	16,294

Shënim:19.3.3.1

Në vlerën e përgjithshme të paraqitur përfshihet sasinë e naftës prej 2,300 litrave që shërben për qëllime të ngrohjes qendrore derisa sasia prej 300 litrave prezanton naftën për nevoja të gjeneratorit.

Neni 21 Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara

	Shënim	Vlera historike 2020	Vlera historike 2019	Vlera historike 2018
Përshkrimi				
Të hyrat venatake të bartura nga viti i kaluar		537	-	-
Të hyrat venatake të pranuar në këtë vit	21.1	19,810	20,000	-
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual		20,347	20,000	-
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	21.2	15,184	19,463	-
Shuma e mbetur për bartje	21.3	5,163	537	-

Shënim 21.1:

Shuma e prezantuar paraqet të hyrat e realizuara për vitin 2020 në shumë prej 19,810€.

Shënim 21.2:

Shuma e prezantuar paraqet shpenzimet e realizuar gjatë periudhës së raportimit.

Shënim 21.3:

Shuma e prezantuar paraqet mbetjen e të hyrave për vitin 2020, të cilat duhet të bartën për shfrytëzim në vitin 2021.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 24 Raport për fondet e donatoreve të pashpenzuara

Shënim	Vlera historike 2020	Vlera historike 2019	Vlera historike 2018
Përshkrimi			
Grantet e përcaktuara të donatorëve të bartura nga viti i kaluar	-	(19,178)	2,489
Grantet e përcaktuara të donatorëve të pranuar në këtë vit	-	114,416	-
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	-	95,238	2,489
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	-	95,238	21,667
Shuma e mbetur për bartje	-	-	(19,178)

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 25. Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit 06/L-133	Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2020		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2019		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2018	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Stafi (Auditor & Mbështetës)	173	171	-	171	-	165	-
TOTALI	173	171	-	171	-	165	-

Shënim shpjegues:

*Numri i punonjësve në fillim të vitit 2020 ishte 170.

**Numri aktual i punonjësve në fund të vitit 2020 është 171.

Neni 26. Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave

Departamenti	Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2020		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2019		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2018	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Ekspert lokal dhe ndërkombëtar	-	-	4	-	2	-
TOTALI	-	-	4	-	2	-

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, veçim nëse përmendet ndryshe)

Neni 27. Raport për numrin e të punësuarve me kontrate për shërbime të veçanta

Departamenti	Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2020		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2019		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2018	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Stafi (Auditor & Mbështetës)	10	-	5	-	6	-
TOTALI	10	-	5	-	6	-

Shënim shpjegues:

Në vitin 2020, ZKA kishte gjithsej 10 (dhjetë) punonjës me kontratë për shërbime të veçanta, prej tyre tetë (8) Auditorë të përkohshëm të angazhuar gjatë periudhës së përgatitjes së raporteve të auditimit (Prill-Qershor 2020); Një (1) punonjës mbështetës nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara për një periudhë katër (4) mujore periudhën (Korrik-Nentor 2020); si dhe një këshilltare-eksperte për dizajn grafik, me qëllim të ofrimit të ndihmes në punimin e dizajneve grafike për raporteve të auditimit të hartuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Neni 28. Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet për Zyrën Kombëtare të Auditimit për vitin paraprak

Nr	Rekomandimi	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vlerësimi i rrezikut
1	Shpenzimet (Mallërat dhe Shërbimet): Ne rekomandojmë që kontratat të protokollohen sipas ligjeve/rregulloreve në fuqi.	Do të merret parasysh rekomandimi i juaj dhe do të përforcohen kontrollet e brendshme.	2020	Është adresuar rekomandimi i dhënë	*
2	Pasuritë jo-financiare: Ne rekomandojmë që menaxhmenti të bëjë përditësimin e regjistrit të pasurive jo financiare sipas raportit të numërimit fizik dhe diferencat të trajtohen sipas rregullores 02/2013.	Sistemi i menaxhimit të e-pasurisë i administruar nga MAP-i dhe nën përgjegjësinë e tyre, gjatë vitit 2019 është riformatuar dhe kjo ka sjellë shumë probleme teknike për të gjitha organizatat buxhetore. Mos funksionaliteti i mirë i sistemit nuk ka ofruar siguri për regjistrimet/çregjistrimet e pasurive përkundër faktit se kemi qenë të detyruar që të dhënat t'i përpusojmë nga disa herë.	2020	Me evitim e problemeve teknike në sistem, të gjitha regjistrimet janë harmonizuar.	*

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

		Inventarizimi i pasurive jo financiare ka përfunduar në janar 2020. Barazimet e inventarit me regjistrin e pasurive ishte në proces gjatë kohës së auditimit dhe tani kjo është çështje e kryer.			
3	Prokurimi: Ne rekomandojmë menaxhmentin që të ndërmarë masat e duhura për të siguruar se rregullësia e procedurave të prokurimit të zbatohet plotësisht.	Në njoftimin standard për dhënie të kontratës, përveç informatave të kërkuara, kemi shenuar edhe emrat e të gjithë ofertuesve dhe çmimin total të secilës ofertë në pjesën për "informata shtesë". Lidhur me rastet e referuara kjo vërtetohet përmes njoftimeve përkatëse: njoftimi me nr. të prokurimit 302-19-2710-1-3-6; me nr. 302-19-3825-1-2-1 dhe me nr. 302-19-3630-1-2-1.	2020	Çështje e zbatuar	*
4	Auditimi i brendshëm: Ne rekomandojmë që menaxhmenti të sigurojë organizimin e departamentit të auditimit të brendshëm sipas praktikave më të mira. Duke pas parasysh që auditori i brendshëm duhet të bëjë auditim të të gjithë proceseve, në disa procese kërkohet që auditori i brendshëm të ketë staf profesional nga TI, legjislatonit, në mënyrë që auditimi të jetë në nivelin e duhur profesional.	Njësia e Auditimit të Brendshëm është organizuar në pajtueshmëri me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe me Udhëzimin përkatës të Ministrisë të Financave. Angazhimi i ekspertëve të fushave të caktuara për auditim të brendshëm bëhet në përputhje me Planin e Auditimit dhe nevojave të përcaktuara nga NJAB. Për shkak se ZKA nuk administron sisteme komplekse, deri më tani nuk është parashtruar ndonjë nevojë specifike për angazhimin e ekspertëve të jashtëm.	2020	Nëse parashtrohet nevoja për ekspertë të jashtëm do të bëhet angazhimi i tyre.	*
5	Miratimi i buxhetit të ZIKA-së: Ne rekomandojmë që menaxhmenti të ndërmarr hapat e duhur në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe Kuvendin në mënyrë që neni 13 pika 4 e ligjit nr. 05 L-055 të përmbushet në tërësi.	Sikurse edhe në vitin paraprak, kjo është kompetencë ekskluzive e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me të cilin edhe jemi në koordinim të plotë për këtë çështje.	2020		

* Vlerësimi i rrezikut nuk është përcaktuar nga Auditori i jashtëm pasi që rekomandimet janë pa ndikim material, për ato dhe janë dhënë në letërën për menaxhmentin.

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2020

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

SHTOJCË: Shpenzimet e ndërlidhura me menaxhimin e pandemisë COVID-19

Nr.	Kodi	Pershkrimi i kodit	Shuma	Qëllimi
1	13610	Furnizime për zyrë	4,912	Kufje për punë në distancë, Maska, Dorëza dhe dezinfektues
2	14020	Mirëmbajtje e ndërtesave	1,186	Dezinfektimi profesional i ndërtesës dhe automjeteve të ZKA-së me qëllim të mbrojtjes së punonjësve nga COVID-19
Gjithsej			6,098	

